



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

*10. Markelian Koça (anëtar)*

*11. Yllka Rupa (anëtare)*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Baisa Sefa, Kwshilltare e Kabinetit.*

*3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

*5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

*6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

*8. Edmond {...}, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami: Përsëritje!*

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 31 janar.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet të merret vendim për 11 çështje.

Nëse jemi dakord me rendin e ditës, unë do të propozoja që të fillonim me çështjen e parë, e cila është një nga çështjet e rëndësishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka të bëjë me përcaktimin e numrit të kuotave për kandidatët që do pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.

Për më shumë detaje ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Përpara jush unë po parashtoj relacionin dhe projektvendimin e radhës që i referohet përcaktimit të numrit të kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë si dhe kandidatë për magjistratë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Nisur nga këto detyrime ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet që, brenda janarit 2024, të përcaktojë numrin maksimal të: i) kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar; ii) kandidatëve për këshilltarë ligjorë; iii) kandidatëve për ndihmës ligjorë, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për këtë vit akademik. Për këtë qëllim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatiti projektvendimin “Për numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar.

Përpara parashtrimit të projektvendimit, është e rëndësishme që në këtë relacion të pasqyrohen treguesit dhe faktorët mbi të cilët është parashikuar numri përkatës maksimal i kandidatëve të përmendur më lart.

Këta tregues dhe faktorë lidhen me: i) situatën në të cilën ndodhet sistemi gjyqësor; ii) ndikimin që ka në sistemin gjyqësor vijimi i implementimit të reformës në drejtësi; iii) kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës në lidhje me ofrimin e formimit fillestar; iv) projeksioni/vizioni i Këshillit për sistemin gjyqësor në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Për numrin maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar:

Vlerësimi i numrit maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, por jo vetëm, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2024-2025, bazohet në:

I) nevojat aktuale për gjyqtarë në sistemin gjyqësor, referuar për këtë numrit të vendeve vakante/pozicioneve të lira të përhershme;

II) nevojat e pritshme për gjyqtarë në sistemin gjyqësor deri në vitin 2027, referuar për këtë numrit të vendeve/pozicioneve në sistemin gjyqësor që pritet të bëhen të lira të përhershme deri në vitin 2027, kur diplomohen kandidatët magjistratë që do të rekrutohen gjatë vitit të ri akademik 2024-2025;

III) nevojat aktuale dhe në vijimësi për gjyqtarë në institucionet e sistemit të drejtësisë;

IV) mundësitë e plotësimit të nevojave aktuale dhe atyre të pritshme në një të ardhme të afërt, referuar për këtë numrit të kandidatëve magjistratë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve 2024-2025-2026, pra gjatë viteve pararendëse me vitin 2027;

V) kapacitetet që ka Shkolla e Magjistraturës.

Nevojat aktuale për gjyqtarë në sistemin gjyqësor:

Numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit (juridiksion i përgjithshëm dhe i posaçëm), i përcaktuar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar me Dekretin nr.9409, datë 27.01.2016 dhe me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.286, datë 18.12.2019, si dhe numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përcaktuar me ligjin nr.8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, është në total 408.

Pasqyra përmbljedhëse përcakton numrin e gjyqtarëve në nivelet e gjyqësorit. Shkalla e parë e Juridiksionit të Përgjithshëm ka 235 gjyqtarë (pozicione), gjykata administrative ka 36, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka 16 gjyqtarë, totali është 287 gjyqtarë, pra pozicione për gjyqtar në gjykatat e shkallëve të para. Vakancat për shkallët e para janë aktualisht, 17 për juridiksionin e përgjithshëm, 5 për Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative dhe 7 për Gjykatën Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka gjithsej vende pozicione 78, Gjykata e Apelit Administrativ 13, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të

Organizuar ka gjithsej 11 pozicione. Totali në nivelin e dytë për pozicione është 102 magjistratë, prej të cilëve vakanca të përhershme në apelin e juridiksionit të përgjithshëm janë 44, vakanca të përhershme në apelin administrativ janë 5 dhe vakancë e përhershme në apelin kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një. Gjykata e Lartë ka 19 gjyqtarë aktualisht efektiv në detyrë.

Pra në gjykatat e shkallës së parë janë gjithsej 30 vende/pozicione; 18 juridiksioni i përgjithshëm; 7 gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe 5 juridiksionit administrativ.

Në gjykatat e apelit në total – 51 vakanca; Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm – 45 vende/pozicione; 5 vende/pozicione juridiksioni administrativ; 1 juridiksioni i posaçëm.

Në Gjykatën e Lartë – 1 vakancë e shpallur, për shkak të mbarimit të mandatit të z.{...}, i cili vijon ushtrimin e funksionin në Gjykatën e Lartë dhe në llogaritjen e përgjithshme të sistemit nuk ndikon në numrin e vakancave.

Aktualisht në sistemin gjyqësor ekzistojnë 81 vende vakante, pra gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, në total janë 81 vende vakante/pozicione të lira të përhershme, që duhet të plotësohen përmes rekrutimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Në numrin 81 të vendeve vakante/pozicione të lira të përhershme në sistemin gjyqësor nuk janë përfshirë, duke mos u konsideruar të lira, 21 pozicione, të cilat i mbajnë 2 gjyqtarë të pezulluar për shkak të çështjeve penale, 19 gjyqtarë të zgjedhur apo komanduar në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë: 6 anëtarë të KLGJ-së dhe 13 të komanduar për periudha afatmesme ose afatgjata, siç do të përmendet më poshtë.

Tabela është bashkëlidhur. Janë rastet e gjyqtarëve të komanduar, gjyqtarët që ushtrojnë funksionin si anëtarë të KLGJ-së, gjyqtarë të pezulluar, me leje, të shkarkuar me vendim të KPK-së, por që ky vendim nuk ka marrë edhe formë të prerë.

Nevojat e pritshme për gjyqtarë në sistemin gjyqësor deri në vitin 2027:

Në një të ardhme të afërt, deri në vitin 2027, në sistemin gjyqësor do të krijohen vende vakante/pozicione të lira të tjera të përhershme si rezultat i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të:

a) Mbushjes së moshës 67 vjeç, - moshë e daljes në pension:

Për periudhën 2024-2027, numri i gjyqtarëve që mbushin moshën për mbarimin e statusit të magistratit, në total është 14 (pra për tre vite është 14). Gjithashtu vlen të theksohet se 2 prej magistratëve mbushin moshën 70 vjeç të daljes në pension, ndërsa 5 prej magistratëve që mbushin moshën për pension (67 vjeç) gjatë kësaj periudhe janë aktualisht të shkarkuar ne vendim të KPK-së (pra jo me vendim të KPA-së), pra janë të pezulluar.

Sipas të dhënave të përditësuara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të shtrira në këtë periudhë, ky numër është:

- Në vitin 2024, rezultojnë 2 magistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie; (1 në gjykatën e shkallës së parë dhe 1 në Gjykatën e Lartë).

- Në vitin 2025, rezultojnë 6 magistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie; (1 në gjykatën e apelit, 4 në gjykatën e shkallës së parë dhe 1 i pacaktuar në organikat e gjykatave – është një magistrat i cili ushtron funksionet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor por që nuk ka një pozicion të caktuar në sistemin gjyqësor).

- Në vitin 2026, rezultojnë 5 magistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie; (5 në gjykatat e shkallëve të para dhe 1 në gjykatën e apelit).

- Në vitin 2027, rezulton 1 magistrat (gjyqtar) që mbush moshën për pension pleqërie; (1 në gjykatat e shkallës së parë).

Në total për periudhën 2024-2027, rezultojnë që 14 magistratë (gjyqtarë) mbushin moshën për pension pleqërie dhe me siguri do krijohen 14 vende të lira gjatë kësaj periudhe kohe.

b) Dorëheqjet:

Referuar të dhënave të përditësuara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, përpara fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, kanë dhënë dorëheqjen nga detyra 3 gjyqtarë. Ndërsa gjatë procesit të rivlerësimit kanë dhënë dorëheqjen 59 gjyqtarë, sipas të dhënave të mëposhtme:

- Në vitin 2017 - 4 gjyqtarë;
- Në vitin 2018 - 3 gjyqtarë;
- Në vitin 2019 - 12 gjyqtarë;

- Në vitin 2020 - 14 gjyqtarë;
- Në vitin 2021 - 14 gjyqtarë;
- Në vitin 2022 - 10 gjyqtarë;
- Në vitin 2023 - 2 gjyqtarë;

Në total për periudhën 2017-2023, rezultojnë 76 magjistratë (gjyqtarë) të cilët janë larguar nga sistemi, nga të cilët 59 magjistratë (gjyqtarë) kanë dhënë dorëheqjen nga funksioni dhe 17 magjistratë (gjyqtarë) janë larguar nga funksioni për shkak të mbushjes së moshës për pension pleqërie (bashkëlidhur është edhe tabela përkatëse). Një pjesë e tyre është edhe pension i parakohshëm, pra mosha 60-vjeçare kanë bërë kërkesë për të dalë në pension të parakohshëm.

Referuar shkaqeve mbarimit të statusit mund të supozohet se, për periudhën 2024-2027, numri i gjyqtarëve që mund të ndërpresin ushtrimin e funksionit me dorëheqje për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë (67 vjeç), në total është 14.

Potencialisht, fenomeni i dorëheqjes së gjyqtarëve mund të vazhdojë edhe në vijim, përgjatë periudhës së procesit të rivlerësimit kalimtar, megjithëse shikohet rënie e kërkesës për dorëheqje gjatë vitit 2023 që pati vetëm 2 (dy) kërkesa. Tashmë kanë mbetur pa përfunduar procesin e vlerësimit kalimtar në KPK vetëm 18 gjyqtarë dhe brenda këtyre duhet të llogarisim se sa mundësi ekzistojnë që gjyqtarët mund të japin dorëheqjen nga ky proces. Pra dhe në themi që është një numër i papërfillshëm duke iu referuar vitit 2023 që kanë qenë 2.

c) I referohemi statistikave që kanë të bëjnë me funksionin dhe veprimtarinë e KPK-së.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prej shkurtit të vitit 2018 kur ka filluar veprimtarinë deri më datë 15.01.2024 (kur është përpiluar fillimisht relacioni), rezultojnë këto të dhëna:

- ka konfirmuar në detyrë 159 gjyqtarë, përfshirë edhe znj. {...}, e cila nuk është caktuar në organikën e ndonjë gjykate;
- ka shkarkuar nga detyra 138 gjyqtarë, nga të cilët 51 magjistratë (gjyqtarë) të shkarkuar nga KPK (të pezulluar dhe paguhen me 75% të pagës së gjyqtarit), duke

përfshirë edhe znj. {...}, e cila nuk është caktuar në organikën e ndonjë gjykatë.

- ende nuk ka dhënë vendim për 18 gjyqtarë të cilët janë subjekt i rivlerësimit kalimtar;

- 98 magjistratë në detyrë nuk janë subjekt i vlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016, pasi ata janë verifikuar tashmë nga KLGJ-ja.

Për 147 magjistratë vendimi i konfirmimit në detyrë nga organet e rivlerësimit ka marrë formë të prerë.

Në performancën e viteve të fundit për veprimtarinë e KPK-së vërehet se:

Gjatë vitit 2022 më shumë se gjysma e tyre, rreth 51,16 % janë konfirmim në detyrë, ndërsa gjatë vitit 2023 janë marrë 26 vendime të konfirmimit në detyrë dhe 11 vendime për shkarkim të magjistratëve, pra 70.2 % e vendimeve janë konfirmim në detyrë.

Mbajtur në vëmendje këtë performancë, pra referuar përqindjes së konfirmimit të përmendur më lart, vlerësohet se në 18 rastet e mbetura afërsisht 13 vendime do të jenë konfirmim në detyrë, referuar përqindjes që përmendëm më lart.

Mbajtur në vëmendjen statistikën e Institucionit të Komisionerit Publik, ku në 159 raste të konfirmimit në detyrë Komisioneri Publik ka ankimuar 37 raste, rreth 23.5%, rezulton se nga këto 13 vendime, afërsisht 4 prej tyre do të ankimohen nga Komisioneri Publik.

Vetë Komisioneri Publik ka ushtruar ankime ndaj vendimeve të konfirmimit në detyrë të 37 gjyqtarëve, pra në 23.5% të rasteve të konfirmimit në detyrë siç është përmendur më sipër (bashkëlidhur është edhe pasqyra përkatëse).

Në 32 raste të shqyrtuara rezulton ky raport:

Për 17 raste apo 53,1 % është vendosur lënia në fuqi e vendimit të konfirmimit; për 14 raste të gjyqtarëve të konfirmuar nga KPK ose 43,7 % të totalit është vendosur shkarkimi nga detyra në KPA; dhe në 1 rast ose 3,1 % të totalit është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit.

Statistika që lidhen me veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA):

KPA ka shqyrtuar 86 ankime të magjistratëve, nga të cilat ka lënë në fuqi 77, ka ndryshuar 7 duke konfirmuar me formë të prerë magjistratët dhe ka prishur 1 vendim



shkarkimi të KPK-së duke e rikthyer edhe një herë çështjen në KPK.

Të shkarkuar nga detyra prej vitit 2018 deri më sot me vendim të formës së prerë, janë 91 gjyqtarë.

Në pritje për t'u shqyrtuar nga KPA-ja, janë 51 ankimime të gjyqtarëve të shkarkuar nga KPK-ja (pa përfshirë znj. Çarçiu). Nga këto KPA-ja ende ka pa shqyrtuar 25 çështje me ankues magjistratë të shkarkuar të regjistruara në vitin 2021; 16 të regjistruara në vitin 2022; 10 çështje të regjistruara në vitin 2023.

Performanca e KPA-së:

Gjatë vitit 2023 KPA ka shqyrtuar 29 çështje të juridiksionit të rivlerësimit ku përfshihen gjyqtarët, nga të cilat 24 shkarkime, ku në 4 raste ankues ishte Komisioneri Publik dhe 5 konfirmime në detyrë, 3 të tilla mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik.

Gjatë vitit 2022 KPA-ja ka dhënë vendime për 34 gjyqtarë, nga të cilat 22 shkarkime – 3 mbi ankimin e Komisionerit Publik; për 8 gjyqtarë është lënë në fuqi në vendimi i konfirmimit dhe për 4 gjyqtarë KPA-ja ndryshoi vendimin e shkarkimit duke i konfirmuar në detyrë.

Gjatë vitit 2021 KPA-ja është shprehur për 14 gjyqtarë, nga të cilat 11 janë vendime shkarkimi – 2 të tillë ishin mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik; për 3 raste të tjera është lënë në fuqi vendimi i KPK-së pas ankimit të Komisionerit.

Gjatë vitit 2020 KPA-ja ka dhënë vendime për 14 gjyqtarë dhe ka lënë në fuqi vendimet e shkarkimit, në 1 rast ka lënë në fuqi vendimin e konfirmimit pas ankimit të Komisionerit Publik dhe në 1 rast ndryshoi vendimin e shkarkimit duke konfirmuar në detyrë.

Gjatë vitit 2019 KPA-ja ka dhënë vendime për 20 gjyqtarë; 18 vendime shkarkimi, 5 nga të cilat mbi ankimin e Komisionerit Publik dhe ka lënë në fuqi 2 vendime konfirmimi pas ankimit të Komisionerit Publik (nuk përfshihen në këto shifra ankimet pas vendimit të KPK-së për dorëheqjeve të gjyqtarëve).

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultojnë se:

- 159 magjistratë (gjyqtarë) janë konfirmuar me vendim të KPK-së, (bashkëlidhur Pasqyra nr.5 që është pjesë e integruar e relacionit).

- nga këta, rezultojnë 14 magjistratë (gjyqtarë) të cilët janë shkarkuar nga KPA-ja,

(bashkëlidhur Pasqyra nr. 5/1).

- 123 magjistratë (gjyqtarë) të cilët janë konfirmuar me vendim të formës së prerë, (bashkëlidhur Pasqyra nr.5/2).

- 37 magjistratë (gjyqtarë) të cilët janë konfirmuar nga KPK-ja janë ankimuar nga IKP në KPA, (bashkëlidhur Pasqyra nr.5/3).

Duke pasur në konsideratë nenin 179/b, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit është 9 vjet. Si konkluzion, deri në këtë kohë, potencialisht, mund të përfundojë procesi i rivlerësimit kalimtar edhe për gjyqtarët e tjerë (pra deri në fund të mandatit të anëtarëve të KPA-së) (tashmë 18 të mbetur)

Mandati i anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit është deri në 17 qershor të vitit 2026. Si rrjedhojë, në sistem do të përfshihen përveç të tjerëve edhe 7 (shtatë) gjyqtarë në gjykatat e apelit të Republikës së Shqipërisë në muajin qershor 2026 (i referohemi 7 gjyqtarëve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit).

Analiza e të dhënave të procesit të rivlerësimit kalimtar:

Nisur nga të dhënat statistikore të procesit të rivlerësimit kalimtar në KPK, vetëm sa i përket vendimeve të konfirmimit dhe shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve, tendenca e deritanishme, pra deri më datë 16.01.2024, tregon se edhe këtë vit ka vijuar tendenca drejt konfirmimeve.

Gjatë vitit 2022 më shumë se gjysma e tyre, rreth 51.16 % janë konfirmim në detyrë, ndërsa gjatë vitit 2023 janë marrë 26 vendime të konfirmimit në detyrë dhe 11 vendime për shkarkim të magjistratëve, pra 70.2 % e vendimeve janë konfirmim në detyrë.

Kjo tendencë, nëse konsiderohen të dhënat e KPA-së rezulton sërish me një kurbë optimiste, duke konsideruar se për 7 (shtatë) gjyqtarë KPA-ja ka ndryshuar vendimin e KPK-së dhe ka vendosur konfirmimin në detyrë të gjyqtarëve, si edhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për 17 ankimime të komisionerit publik.

Gjatë vitit 2023 KPA-ja ka shqyrtuar 29 çështje të juridiksionit të rivlerësimit ku përfshiheshin gjyqtarët në këto raste.

Në 22 çështje ku ankues është magjistrati, në 20 raste ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkarkimit të KPK-së, ndërsa në 2(dy) raste të tjera ka vendosur ndryshimin e vendimit të KPK-së duke konfirmuar në detyrë gjyqtarët. Në 7 (shtatë) çështje ku ankues është Komisioneri Publik në 4 raste është vendosur ndryshimi i vendimit të KPK-së dhe shkarkimi nga detyra i magjistratëve, ndërsa në 3 raste është vendosur lënia në fuqi e vendimit të KPK-së për konfirmimin në detyrë të gjyqtarëve.

Nisur nga të dhënat statistikore të procesit të rivlerësimit kalimtar në KPA, vetëm sa i përket vendimeve të lënies në fuqi dhe atyre të cenuara, gjithsej 115, tendenca e deritanishme, pra deri më datë 25.01.2024, tregon se në 82% të rasteve KPA-ja ka lënë në fuqi vendimin e KPK-së, ndërsa në 19% të rasteve, KPA-ja ka cenuar vendimin e KPK-së.

Mund të evidentohet se KPA-ja, nga 86 raste të vendimeve të shkarkimit nga detyra të KPK-së, (me ankues gjyqtar) vetëm në 7 raste apo 8.1 % të rasteve totale, ka dhënë vendim në favor të konfirmimit në detyrë të gjyqtarit dhe në 1 rast e ka kthyer çështjen për rigjykim në KPK.

Mund të evidentohet se KPA-ja, nga 86 raste të vendimeve të shkarkimit nga detyra të KPK-së, (me ankues gjyqtar) në 78 raste apo 90 % të rasteve totale, ka lënë fuqi vendimin e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit dhe në 1 rast e ka kthyer çështjen për rigjykim në KPK.

Marrë në konsideratë kohëzgjatjen e deritanishme të shqyrtimit të çështjeve në KPA, deri në 24-36 muaj, numrit të rasteve që janë apo do të jenë patjetër për shqyrtim në KPA, gjithsej 57 raste (52 raste në shqyrtim të ankimua nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe 5 vendime konfirmimi të ankimua nga Komisioneri Publik), si dhe tendencën e derisotme të përfundimit të çështjeve në KPA, mund të supozohet se në një të ardhme të afërt, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar, në sistemin gjyqësor mund të krijohen 48-49 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Gjithsesi, edhe mbi një parashikim më optimist sesa ky që përmendëm më lart të tendencës së përfundimit të çështjeve në KPA, 50% (shkarkime) me 50% (konfirmime ose lënie në fuqi të vendimeve të konfirmimit në detyrë), në një të ardhme të afërt, deri në

vitin 2027, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar, në sistemin gjyqësor, me shumë gjasë do të krijohen 28 – 29 vende vakante/pozicione të lira të përhershme. Referenca është 50 % me 50 %.

Duke marrë në konsideratë projeksionin e ndërmjetëm, midis përqindjes së sotme 90 % të rasteve të lënies në fuqi të vendimeve të shkarkimit nga KPA dhe projeksioni optimist 50% me 50% i cili arrin në 70 % të rasteve, mund të supozohet se në një të ardhme të afërt, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar, në sistemin gjyqësor mund të krijohen 39 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Treguesit më lart të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve vlejné për t'u mbajtur në konsideratë, në mënyrë që procesi aktual i rekrutimeve të mund të pakësojë pasojat negative në funksionimin e sistemit gjyqësor në një të ardhme të afërt, pra efektet që mund të vijnë nga ky proces gjatë tre viteve në vazhdim të mund të kapërcehen përmes rekrutimit të një numri të mjaftueshëm kandidatësh për magistratë, profili gjyqtar.

ç) Shkarkimit nga detyra në kuadër të procedimeve disiplinore:

Deri më datë 16.01.2024, procedimet disiplinore që janë shqyrtim ose të pezulluara pranë Këshillit, në 3 raste kërkohet shkarkimi nga detyra i gjyqtarit. Këto procedime janë pezulluar për shkak të pritjes së vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, e si të tilla rezultatet e tyre nuk ndikojnë në analizën e vakancave të sistemit, pasi llogariten në rubrikën e vakancave potenciale nga procesi i rivlerësimit kalimtar.

Ndërkohë, nën procedim penal për kryerjen e një krimi janë edhe 2 gjyqtarë të tjerë, që mbajnë pozicionin në mënyrë të përhershme në sistemin gjyqësor.

Pra, sa më sipër, në një të ardhme të afërt, me siguri, në sistemin gjyqësor mund të krijohen të paktën edhe 2 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Përfundime:

Sa më lart, referuar germave (a), (b), (c) dhe (ç), ajo çka mund të supozohet aktualisht është se nevojat në një të ardhme të afërt në sistemin gjyqësor mund të jenë për 55 gjyqtarë. (14 rasti i dorëheqjeve ose daljes në pension, 0 është rasti i dorëheqjeve si rubrikë më vete, 39 janë raste të shkarkimeve nga KPK-ja, KPA-ja dhe 2 janë raste për

shkak të procedimeve penale që janë të lidhura me procedimet disiplinore).

Nevojat aktuale dhe në vijimësi për gjyqtarë në institucionet e sistemit të drejtësisë:

i) Anëtarët gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Legjislacioni në fuqi parashikon që në përbërjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë 6 gjyqtarë, që shërbejnë me kohë të plotë për një periudhë 5-vjeçare.

Aktualisht, në Këshillin e Lartë Gjyqësor shërbejnë 6 gjyqtarë, të zgjedhur nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor, për 3 nga të cilët mandati përfundon në dhjetor 2026, dhe në vend të tyre do të zgjidhen 3 anëtarët të rinj, ndërsa për 3 të tjerë mandati përfundon në dhjetor 2028.

6 gjyqtarë do të shërbejnë si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke mos ushtruar kështu funksionin në sistemin gjyqësor për një afat prej 5 vjetësh.

Nga ana tjetër, legjislacioni në fuqi parashikon mundësinë e shërbimit të gjyqtarëve, për periudha afatgjata, deri në 5 apo edhe 10 vjet, në pozicione të caktuara në institucionet e sistemit të drejtësisë, përmes procedurave të komandimit të tyre. Parashikimi i institutit të komandimit i gjyqtarëve në institucionet e sistemit të drejtësisë duket që është bërë në funksion të mirëfunksionimit të këtyre institucioneve, duke konsideruar shërbimin e gjyqtarëve në to si një kontribut të rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve të tyre. Për disa nga këto institucione, vetë ligji ka parashikuar, jo vetëm vazhdimësinë e shërbimit të gjyqtarëve, por edhe numrin e tyre, sikundër edhe afatin e shërbimit/komandimit. Vazhdimësia e shërbimit të gjyqtarëve në këto institucione, nënkupton se ai numër gjyqtarësh në vijimësi nuk do të ushtrojë funksionet në sistemin gjyqësor, çka do të thotë se përveç një numri të mjaftueshëm gjyqtarësh në sistemin gjyqësor, duhet të konsiderohet pasja edhe një numër tjetër gjyqtarësh që do të duhet të shërbejnë në institucionet e sistemit të drejtësisë (Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës dhe çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit me legjislacionin).

Nuk po ndalem për ecurinë e komandimeve që ne kemi bërë në institucionet e rëndësishme si dhe për nevojat që kanë këto institucione me kërkesat që ata janë drejtuar

Këshillit të Lartë Gjyqësor për të hapur vendet vakante. Pra këtu përmend Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Këshilltarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional, si dhe në KLGJ, Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë.

Përfundime:

Brenda numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, në vijimësi, sipas përcaktimeve ligjore dhe organikave aktuale të institucioneve të sistemit të drejtësisë, jo më pak se 30 gjyqtarë do të duhet të shërbejnë në këto institucione, çka do të thotë që ky numër, duhet të llogaritet brenda numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve mbajtur në konsideratë edhe organikën aktuale (pra nga 408, numër 30 gjyqtarë është pjesë e tyre dhe nuk është shtesë e 408).

Plotësimi i nevojave në sistemin gjyqësor:

Numri i kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës deri në vitin 2026, është si më poshtë:

Viti 2024 pritet të diplomohen 32 magjistratë.

Viti 2025 është 45 + 1.

Viti 2026 është 40 magjistratë.

Në total në tre vite pritet të diplomohen 118 magjistratë.

Sa më lart, referuar nevojave aktuale në sistemin gjyqësor sipas pikës së parë, pra 79 vende vakante/pozicione të lira të përhershme, ato do të mund të plotësohen që në vitin 2025, pra me diplomimin e vitit të tretë dhe të dytë të Shkollës së Magjistraturës.

Ndërkohë deri në vitin 2027 mbi supozimet e mësipërme, është e pritshme që në sistemin gjyqësor të krijohen deri 55 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Një pjesë e tyre mund të plotësohen me një pjesë të magjistratëve që diplomohen në vitin 2026 (118 të diplomuar në total, minus 79 vakanca aktuale = 39 magjistratë të diplomuar të gatshëm për plotësim vakancash).

Nisur nga kjo, është e qartë se vakancat e përhershme që pritet të krijohen në sistemin gjyqësor deri në vitin 2027 (që supozohen të jenë 55) nuk mund të plotësohen nga magjistratët e diplomuar deri në këtë vit (55 vakanca minus 39 magjistratë të diplomuar, mbetin 16 vakanca).

Këto vakanca, mbeten të plotësohen me të diplomuarit e vitit 2027, të cilët do të nisin formimin fillestar në vitin akademik 2024-2025.

Sa më sipër, ndërsa mund të supozohet që, në vitin 2027, në sistemin gjyqësor do të ketë jo më pak se 55 vende vakante/pozicione të lira të përhershme, për plotësimin e këtyre vakancave do të duheshin jo më pak se 16 të diplomuar në këtë vit, çka do të thotë se numri i kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, që duhet të rekrutohen në vitin e ri akademik 2024-2025, do të duhet të jetë jo më pak se 16.

Por do të duhet të rikonsiderohet fakti se qershor 2026 përfshihen në sistem edhe 7 anëtarë të KPA-së, gjithashtu edhe qëndrimet që ka mbajtur së fundi edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimet e fundit për rihapjen e proceseve ndaj magjistratëve të shkarkuar.

Gjithashtu në këtë llogaritje janë marrë dy herë në analizë vakancat për shkak të moshës së pensionit dhe të shkarkimit për magjistratët. Thamë, ajo pjesë e marrë në analizë që do dalin në pension është edhe pjesë e shkarkimeve nga KPK-ja.

Të tjerë tregues për t'u mbajtur në konsideratë janë: efiçenca e KPA-së e cila ka ende në shqyrtim çështje të juridiksionit të rivlerësimit kalimtar që i përkasin vitit 2020 e nga ana tjetër mandati i saj përfundon në qershor 2026; si edhe kohëzgjatja e procedurës së promovimit/ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, e cila diktohet ndër të tjera edhe nga KPA. pra promovimin e bëjmë ne, por kjo procedurë është e ndërvarur edhe me procedurën e vendeve vakante që krijon KPA-ja me vendimmarrjet e saj.

Komisioni, mbajtur në konsideratë sa më sipër propozon që kuotat për magjistratë në vitin 2024-2025 të parashikohen të jenë 20.

Në këtë konkluzion arrihet duke mbajtur në vëmendje këto tregues:

- Performancën aktuale të KPA, ku në fakt në 90 % të rasteve totale të shkarkimit nga detyra lihet në fuqi vendimi i shkarkimit. Në situatën aktuale të ankimeve të regjistruara në KPA me ankues magjistrat, kjo përkthehet me shifrën se rreth 46 magjistratë do të shkarkohen dhe jo 39 (siç e kishim llogaritur ne) si edhe shkarkime në rastet kur ankues është Komisioneri Publik +2, i shtohen 9 vakanca të pritshme.

- Numri i gjyqtarëve të KPA të cilët do të shtohen në sistem (me siguri ne themi është 6-7 sepse janë gjyqtarë të KPA-së);

- Llogaritja për 5 gjyqtarë të shkarkuar si në përfundimin e statusit për shkak pensioni, ashtu edhe për shkak të rivlerësimit kalimtar.

- Përfundimi i të gjitha çështjeve të rivlerësimit kalimtar brenda mandatit 9-vjeçar të KPA-së të caktuar me ligj (qershor 2026);

- treguesi 71% e vakancave aktuale të cilat mund të përmbushen vetëm me procedurën e ngritjes në detyrë nga ana e Këshillit (vakancat në gjykatat e apelit dhe gjykatën e posaçme të shkallës së parë janë pjesë e procedurës së ngritjes në detyrë dhe këto janë 71% e vakancave aktuale në sistemin gjyqësor. Pjesa tjetër e vakancave i përket gjykatave të shkallëve të para ku Këshilli ndjek procedurën e lëvizjes paralele.

- Konkluzionet për projeksionet e kuotave sipas simulimit Monte Karlo.

Eksperti Ndërkombëtar i Administrimit Gjyqësor Dr. {...}, ka vlerësuar nevojën për gjyqtarë të rinj në Shkollën e Magjistraturës, nëpërmjet projeksioneve si ekspert i jashtëm, i cili vjen në ndihmë edhe relacionit që ne kemi përgatitur.

Modeli bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Procesi i rivlerësimit do të vazhdojë derisa të gjithë gjyqtarët të jenë verifikuar përfundimisht.

- Në çdo muaj të ardhshëm vendimet e vettingut nga KPK dhe KPA do të jenë të ngjashme me vendimet aktuale të marra në një nga muajt e periudhës 2022-2023 dhe numri i dorëheqjeve nga gjyqtarët nën vetting do të ndjekë gjithashtu modelin e mëparshëm. Supozohet se ka më shumë gjasa që modeli i ardhshëm i vendimeve të ngjajë me vendimet e marra në vitin 2023.

- Supozohet se ritmi i punës si i KPK ashtu edhe i KPA do të jetë i njëjtë si në muajt e mëparshëm.

- Në vitin 2024 do të shtohen 32 gjyqtarë të rinj dhe më pas 45 në 2025. Gjyqtarët e rinj do të hyjnë në sistem në gjysmën e dytë të vitit.

- Supozohet se rreth 30% e konfirmimeve të ardhshme nga KPK do të apelojnë, dhe se 95% e shkarkimeve të ardhshme do të apelojnë.

- Mesatarisht 2% e gjyqtarëve do të largohen nga sistemi çdo vit për arsye që nuk lidhen me vetingun.

Dy variante të ndryshme të modelit janë paraqitur në vijim:



1. Një model që supozon se numri i gjyqtarëve të rinj të shtuar në sistem çdo vit pas vitit 2025 do të jetë 45 gjyqtarë.

2. Një model që supozon se numri i gjyqtarëve të rinj të shtuar në sistem çdo vit pas 2025 do të jetë 25 gjyqtarë.

Sipas konkluzioneve të këtij modeli rezulton se: “Modeli tregon se edhe me 45 gjyqtarë të rinj çdo vit në 2026 dhe 2027, numri i dëshiruar i gjyqtarëve (408) do të duhet të plotësohet rreth vitit 2028. Me vetëm 25 gjyqtarë të rinj çdo vit (nga viti 2026 e në vijim), do të ketë një vonesë të mëtejshme prej tre vitesh shtesë përpara se të arrihet numri i plotë i gjyqtarëve. Në vitin 2024 pritet të diplomohen 32 gjyqtarë nga Shkolla e Magjistraturës dhe në vitin 2025 janë 45. Nga analiza e mësipërme mund të arrihet në përfundimin se opsioni më i mirë i ofruar nga ekspertiza duket të jetë mbajtja e numrit të gjyqtarëve të rinj në 45 për të paktën dy vite të tjera (2026 dhe 2027). Nëse kuota ulet në p.sh. 25 me gjasë do të duhet deri në vitin 2031 për të arritur objektivin e dëshiruar.

Për të pasur një numër të mjaftueshëm të vendeve të lira të gjykatës së shkallës së parë për gjyqtarë të rinj do të jetë e nevojshme të rritet ritmi i ngritjeve në detyrë në gjykatat e apelit. Numri vjetor i promovimeve duhet të jetë rreth 15 ose më i lartë. Pra jo më pak se 15 promovime në vit.

Qëndrimi i Komisionit lidhur me këto projeksione.

- Vihet re se në këto supozime janë të bëra duke marrë në konsideratë vetëm numrin e magjistratëve që dalin në dy vitet e fundit (vitin e tretë dhe vitin e dytë). Ndërkohë ne kemi bërë analizën duke iu referuar edhe vitit të parë të Shkollës së Magjistraturës që ka filluar këtë vit akademik (viti 2023 – 2024, në muajin shtator – tetor ka filluar viti i parë që janë 40 magjistratë); dhe projeksioni ka marrë në konsideratë vetëm dy vitet e tjera të Shkollës së Magjistraturës dhe nuk ka përfshirë vitin e parë aktualisht në Shkollën e Magjistraturës që është një numër prej 40 magjistratësh, pra është 1/3 e numrit të të diplomuarve për 3 vitet e ardhshme.

Pra, konkluzionet e këtij modeli i referohen situatës në mënyrë pjesore (sepse ka marrë në konsideratë vetëm 2 vite) dhe nuk ka marrë në konsideratë vitin e parë). Kështu që ne dakordësohemi me konkluzionet e arritura nga ekspertiza por fusim në projeksionin tonë edhe vitin e parë të Shkollës së Magjistraturës që është një numër 40 që do të jenë

pjesë e sistemit gjyqësor për tre vitet e ardhshme, pra deri në vitin 2026.

Pjesa tjetër i referohet edhe performancës sonë, pra performancës së punë sonë ku eksperti sugjeron që të paktën në vit ne duhet të nxjerrim 15 promovime, që janë ngritje në detyrë. Që edhe kjo është një punë shtesë, referuar burimeve njerëzore që ne kemi në dispozicion; e dyta, referuar edhe marrëdhënieve që kemi edhe me institucione të tjera (ILD, KPA), praktikisht na e bëjnë të pamundur, të paktën deri më sot, nuk i kemi arritur këto rezultate të kërkuara, për shkak të ndërvartësisë së punës sonë dhe të burimeve tona njerëzore. Pra është e vështirë parashikimi i sugjeruar nga eksperti në promovimin e 15 gjyqtarëve në vit nga ana e KLGJ-së.

Për të vijuar më tej.

Mbi kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës:

Shkolla e Magjistraturës me shkresën e datës 11.01.2024 informon se: “Shkolla e Magjistraturës prej vitit 2020 ka krijuar kapacitetet e nevojshme akademike dhe organizative për realizimin e procesit të formimit fillestar në katër klasa. Bazuar në ligj dhe në rregulloren e Shkollës, procesi i Formimit Fillestar, në vitin e parë, zhvillohet bashkërisht për kandidatët për gjyqtarë, prokurorë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Këtë parashikim ka ndjekur edhe përbërja e secilës klasë, ku numri i kandidatëve nuk ka kaluar 20 kandidatë për çdo klasë. Vlerësojmë se ecuria e procesit mësimor gjatë këtyre viteve ka përmbushur objektivin parësor të shkollës, atë të realizimit të një procesi mësimor cilësor dhe ka lejuar Shkollën të jetë efiçente në përmbushjen e kërkesës së sistemit të drejtësisë për të plotësuar vendet vakante me magjistratë të rinj të trajnuar nga Shkolla.”

Mbi koordinimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

Nga ana e përfaqësuesve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas bisedave të organizuara nga ana e Komisionit, u konsiderua e domosdoshme që, brenda kapaciteteve rekrutuese të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025, numri maksimal i kandidatëve magjistratë, profili prokuror, të ishte jo më pak 40. Pra nëse në vitet e mëparshme ne kemi propozuar numrin mesatarisht 40 të kandidatëve me profil gjyqtar dhe normalisht merrnin pjesën më të madhe të kandidatëve për shkak se 40 e parë përzgjidhej si kandidatë në profilin gjyqtar, pjesa e mbetur që nuk arrinte numrin e kërkuar i përkiste profilit prokuror. Në këtë pikë, prokurorët, mbas komunikimeve që

kemi bërë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ata kanë propozuar që këtë vit numri maksimal i kandidatëve që ata kërkojnë për të mbushur pjesën e sistemit, si prokurorë, të jetë jo më pak se 40. Pra ky propozimi ynë i numrit 20 përkon edhe me propozimet dhe nevojat që ka Këshilli i Lartë i Prokurorisë për të plotësuar vakancat e lira që ata kanë në sistemin e tyre.

Sa më lart, në konsideratë të kapaciteteve rekrutuese të Shkollës së Magjistraturës, por edhe koordinimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, numri maksimal i kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, si dhe i kandidatëve ndihmës ligjorë, që duhet të rekrutohen për vitin akademik 2024-2025, mbetet të përcaktohet në total 32. (20 kandidatë magjistratë, profili gjyqtar dhe 12 kandidatë profili ndihmës ligjor).

Për numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë ligjorë:

Gjykata e Lartë ka në organikën e saj 19 gjyqtarë. Aktualisht të emëruar në këtë funksion janë 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë, ndërkohë që mandati i njërit prej tyre, është i pezulluar, sepse ai ushtron funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në detyrë janë 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke zhvilluar procedurat e ngritjes në detyrë për 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Pozicioni është i lirë, por aktualisht në atë pozicion ushtron funksionet një gjyqtar dhe është në pritje të zëvendësimit të tij nëpërmjet procedurës së promovimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Si dhe më lart, referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, rezulton se sipas organikës së këtij institucioni, numri i këshilltarëve ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor është 31 (tridhjetë e një), nga ku mund të deduktohet se numri i këshilltarëve ligjorë jo magjistratë, që duhet të shërbejnë në këtë njësi, është 15. Pra 19 gjyqtarë dhe 15 këshilltarë ligjorë.

Në Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë ushtrojnë aktualisht detyrën 20 këshilltarë ligjorë jomagjistratë, nga të cilët 7 prej tyre janë në proces të rivlerësimit kalimtar sipas nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.84/2016.

Nga të dhënat e strukturës së Gjykatës së Lartë vërehet ulje e numrit të njësisë ligjore (19 gjyqtarë, 15 këshilltarë ligjorë jomagjistratë).

Me qëllim përballimin e stokut aktual të dosjeve propozohet që në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë të rritet numri i këshilltarëve ligjorë nga 31 që është aktualisht, të shkojë në 38 këshilltarë ligjorë, prej të cilëve 20 duhet të jenë ndihmësmagjistratë të komanduar (pra gjyqtarët që komandohen në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë). Pjesa tjetër e mbetur duhet të jetë strukturë që të plotësohet nga këshilltarët ligjorë jomagjistratë.

Sa më lart, nevoja aktuale për këshilltarë ligjorë jogjyqtarë në Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë, është plotësuar me të diplomuarit e viteve të mëparshme, pra sepse kemi 20 aktualisht (18 është e plotësuar), por ne themi që të rritet struktura. Këtë pjesë ne vetëm e propozojmë, se s'kemi folur me Departamentin e Buxhetit. Ne vetëm e propozojmë. Normalisht, në Gjykatën e Lartë, gjyqtari i Gjykatës së Lartë duhet normalisht të asistohet nga një këshilltar ligjor jomagjistrat dhe një ndihmës magjistrat i komanduar, në projektionin e një rregulli të përpjesëtimit midis ngarkesës që duhet të mbajë këshilltari ligjor jomagjistrat me ndihmës magjistratin e komanduar. Pra ky është propozimi ynë për këtë pjesë. Siç ka qenë historikisht në veprimtarinë ekzistuese të Gjykatës së Lartë përpara se të ndodheshim në situatën aktuale ku ne jemi.

Sa më lart, në vitin akademik 2024-2025, nuk parashikohen kuota për kandidatët për këshilltarë ligjorë. Edhe në supozimin për ndonjë efekt të mundshëm negativ nga procesi i rivlerësimit kalimtar dhe ai i verifikimit të pasurisë dhe figurës për këshilltarët në detyrë, sërish numri i këshilltarëve ligjorë është tejkualuar (20 me 18).

Për numrin maksimal të kandidatëve ndihmës ligjorë:

Në zbatim të ligjit nr.98/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 495, datë 21.10.2020, "Për krijimin e njësisë të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit", vendosi krijimin e "Njësisë së Shërbimit Ligjor" si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit, që janë në total 51 pozicione.

Aktualisht, në njësitë e shërbimit ligjor të gjykatave të apelit janë të emëruar definitivisht ose përkohësisht 31 ndihmës ligjorë nga të cilët 17 prej tyre janë në proces rivlerësimi kalimtar sipas nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.84/2016. Në këto njësi shërbimi janë 19 pozicione vakante.

Pra, aktualisht, njësitë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit paraqesin nevojë për

12 ndihmës ligjorë (mbajtur në konsideratë se 7 ndihmës ligjorë diplomohen në vitin 2024).

Ndërkohë, sipas ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, në nenin 42 parashikohet: “Pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton numrin e ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë duke u bazuar në domosdoshmërinë e tyre për mbarëvajtjen e punës në gjykatë, pasi ka vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 15, pika 3, shkronja “b”, të këtij ligji, llojin dhe natyrën e çështjeve për t’u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, si dhe pas marrjes së mendimit të Këshillit të Gjykatës, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve”

Sa i përket këtij parashikimi ligjor, për numrin e ndihmësve ligjorë pranë gjykatave të shkallëve të para, vlerësohet se kjo nevojë të analizohet në vitin e ardhshëm pasi të ketë dhënë efektet harta gjyqësore, pra jo për ndihmësit ligjorë në gjykatat e shkallës së parë – e vlerësojmë për vitin që vjen.

Përfundime:

Në rrjedhojë të kësaj, duke mbajtur në konsideratë nevojat aktuale dhe ato të pritshme në një të ardhme të afërt, lidhur me numrin e kandidatëve për ndihmës ligjorë, që duhet të rekrutohen në vitin e ri akademik 2024-2025, ky numër, sipas projektvendimit të propozuar, është menduar të përcaktohet në 12, duke mbajtur në vëmendje kërkesat e viteve të kaluara për këtë pozicion. Pra kemi mbajtur në konsideratë edhe se sa kërkesa kanë ardhur për t’u përfshirë në programin e trajnimit fillestar si ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës, që për hir të së vërtetës nuk i ka plotësuar kuotat e kërkuara nga KLGJ-ja në këto vite.

Struktura e projektvendimit:

Mbi Projektvendimin “Për numrin e kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar dhe të kandidatëve ndihmës ligjorë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”.

Projektvendimi, pika 1/a, parashikon që numri i kandidatëve për magjistratë/profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024 - 2025, të jetë 20 (njëzet), ndërkohë që pika 1/b parashikon se numri i kandidatëve ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024 - 2025, të jetë 12 (dymbëdhjetë) kandidatë ndihmës ligjorë.

Më tej, sipas projektvendimit, pika 1/c, parashikohet se në rast se nga konkurrentët nuk arrihen pikët që nevojiten për kandidatët magjistratë, kuotat e mbetura mund t'i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve ndihmës ligjorë, të cilët plotësojnë nivelin minimum të pikëve që parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Në projektvendim, pika 2, parashikohet se Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për kandidime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, sipas pikës 1, germa “a”, të këtij vendimi, nëpërmjet shpalljes së njoftimit: i) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës; ii) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.

Pika 3 e projektvendimit, përcakton se procesi i regjistrimit për konkurrim të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, bëhet në Shkollën e Magjistraturës dhe vlerësimi paraprak për plotësimin e kriterëve kryhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pika 4 e projektvendimit, përcakton se Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për ndihmës ligjorë, për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara: i) pranë gjithë gjykatave; ii) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Ndërkohë, sipas pikës 5 të projektvendimit, përcaktohet se afati për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nga kandidatët e interesuar për magjistratë/profili gjyqtar, si dhe për ndihmës ligjorë, është deri më datë 28 shkurt 2023.

Projektvendimi, në pikën 6, ka të parashikuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojë kandidati ndihmës ligjor, për t'u pranuar në provimin e pranimit në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, referuar për këtë në nenet 34/6, 55/1, 56, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime) dhe nenit 21, të Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në pikën 7, është përcaktuar edhe dokumentacioni që duhet të paraqes kandidati ndihmës ligjor në momentin e aplikimit.

Projektvendimi, pika 8, përcakton se procesi i regjistrimit për konkurrim i kandidatëve ndihmës ligjorë kryhet në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, dhe se kandidatët që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit për pjesëmarrjen në konkurs sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës (pika 9).

Së fundi, në projektvendim përcaktohet edhe momenti i hyrjes në fuqi të vendimit, dhe botimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur relacionit është projektvendimi përkatës dhe tabelat që unë i parashtrova në prezantimin e këtij relacioni. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Kemi ndonjë diskutim?

Në fakt unë vetëm për ndihmësit ligjorë do të kisha, nëse mund ta rrisim pak kuotën. Duke marrë parasysh se Grupi i Punës për backlog-un është duke ndryshuar numrin e përgjithshëm të ndihmësve ligjorë që duhet të jenë për Gjykatën e Apelit Administrativ, gjithashtu po vlerësohet edhe numri i shkallës së parë për ndihmës ligjorë (duke qenë që ligji parashikon tashmë që duhet të ketë edhe në shkallë të parë).

Në fakt ligji nuk ka kufizim, e ka ndryshuar tashmë, e lë në diskrecion të KLGJ-së në bazë të nevojës. Por nëse nuk bëjmë një vlerësim të çështjeve dhe të gjykatës, të gjithë këto procese ishin të ndërvarura nga procesi i hartës gjyqësore. Procesi i hartës me vakancat që kishim, tashmë që ne e kemi të qartë strukturën apo hartën që kanë gjykatat, ne dimë edhe strukturat e tyre dhe tashmë po mundohemi që të bëjmë një vlerësim që sa ndihmës ligjorë duhen në një gjykatë, qoftë të shkallës së parë, qoftë të apelit, dhe Grupi i

Punës, duke marrë parasysh, është duke e bërë këtë vlerësim. Ajo që referon me të drejtë Komisioni, janë strukturat bosh që ne kemi. Sepse kur kemi krijuar strukturat (njësinë ligjore), kemi ecur me logjikën që ligji parashikonte, që duhet të jetë jo më shumë se gjysma e numrit të gjyqtarëve. Dhe në fakt aq është nevoja “de facto” që relacion Komisioni. Thjesht unë e shtroj si një ide, nëse neve po mundohemi që t’i rrisim këto, se qëllimi i Grupi të Punës që po punon është që të rritet stafi në administrata duke qenë se ka nevojë gjykata. A mundemi ne ndoshta ta rrisim lehtësisht këtë gjë? Nëse ne nuk kemi mundësi dhe Komisioni thotë që jo, nuk bëhet...

Deri te 15?

Po mirë, 15, se ne e kemi të qartë që edhe ato nuk i marrim.

(në përgjigje të një anëtari që flet pa ndezur mikrofonin) – Kjo do jetë një tjetër vendimmarrje që kërkon edhe një pasqyrë financiare më të detajuar sepse Grupi i Punës mund të vijë edhe me një propozim për rritje të numrit të gjyqtarëve në një gjykatë në nevojë, domethënë që mund të kërkojë mbi 408. Ne nuk e dimë se kush do jetë propozimi i Grupit të Punës. Por nëse kemi parasysh nevojat që ka sistemi, apelet, kjo ishte si një reflektim, nëse ju e gjykoni. Po ashtu e lëmë edhe kaq, se Komisioni ka bërë një analizë shumë të detajuar mbi vendet vakante.

Po Irena!

**Irena Plaku:** Për sa i përket Grupit të Punës, në fakt ka disa propozime nga eksperti i huaj për rritjen e numrit të gjyqtarëve në disa gjykata, kryesisht gjykata administrative, por ajo që theksohet është normalisht rritja e stafit, sepse numri i gjyqtarëve shkon tek numri i çështjeve që regjistrohen çdo vit, por rritja e stafit është e domosdoshme, aq më tepër në këtë situatën aktuale, kur numri i çështjeve të prapambetura është shumë i madh dhe ajo që propozohet është që të kemi staf ndihmës por edhe këshilltarë, ndihmës ligjorë që është akoma më e domosdoshme. Por kur ne aktualisht nuk kemi ndihmës edhe për shkak të numrit të aplikimeve, pavarësisht se ne kemi përcaktuar kuota vit për vit, është menduar edhe një lloj situatë për të “përdorur”/shërbyer edhe stafi, sekretaria gjyqësore dhe stafi tjetër. Por ajo që është më e domosdoshme janë ndihmësit ligjorë. Kështu që mund të rritet numri i ndihmësve,



pavarësisht se unë nuk besoj që përsëri do kemi një numër të lartë aplikimesh. Mendohet që ndër të tjera do të ketë edhe një ndryshim ligjor sa i përket ndihmësve ligjorë, mënyrës së rekrutimit të tyre. Ne e dimë, të paktën në këto dy vite që unë jam në Këshill, që nuk ka asnjë lloj interesi ose aplikojnë dhe më pas tërhiqen, bëhen ato verifikimet e para dhe më pas tërhiqen. Por mbase duke pasur edhe një numër të vogël të gjyqtarëve këtë vit, që janë 20, mund të ndikojë që mund të kemi më shumë ndihmës ligjorë. Nuk e dimë. Urojmë të kemi në fakt sepse nuk duhen vetëm për apelin por edhe për shkallët e para.

Për shkak se ne e dimë, të paktën në këto dy vite që unë jam në Këshill, që nuk ka asnjë lloj interesi ose aplikojnë dhe më pas tërhiqen. Por edhe duke pasur një numër më të vogël të gjyqtarëve këtë vit që janë 20, mund të ndikojë që të kemi më shumë ndihmës ligjorë. Nuk e dimë. Urojmë të kemi në fakt sepse nuk duhen vetëm për apelin, por edhe për shkallët e para.

**Naureda Llagami:** Atëherë, mund ta kalojmë nga 12 në 15 si propozim konkret, duke qenë se na e lejon edhe struktura?

**Klodian Kurushi:** Jam shumë dakord. Duke ditur edhe nevojat e sistemit, nevojat e gjykatës, nevojat e gjyqtarit për të performuar më shpejt, i duhet edhe ndihma përkatëse, neve propozojmë ndryshim në propozimin që kemi dërguar, për numrin e ndihmësve ligjorë, mbi bazën edhe të reflektimit edhe të sugjerimit të kolegëve, propozojmë nga numër 12, pra nga propozimi i parë heqim dorë dhe e ndryshojmë këtë lloj propozimi dhe e çojmë në 15 numrin e ndihmësve ligjorë, duke inkurajuar edhe më tepër kandidatët për të kandiduar pse jo, jo vetëm si kandidatë gjyqtarë dhe prokurorë, por edhe si ndihmës ligjorë. Kështu që ky është ndryshimi i radhës që bëjmë në projektvendimin e sjellë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Kurushi!

E hedhim në votim me gjithë propozimin për ndryshimin që u pranua.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti lidhur me numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik sipas propozimit të dakordësuar bashkë me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës ku kuota e gjyqtarëve është 20 kandidatë dhe kuota e ndihmësve ligjorë është 15 kandidatë. Për të tjerat propozimi është siç ka qenë nga Komisioni.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raport vjetor i veprimtarisë së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

*10. Markelian Koça (anëtar)*

*11. Yllka Rupa (anëtare)*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*

*3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

*5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

*6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

*8. Edmond {...}, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raport vjetor i veprimtarisë së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës.

Në fakt bëhet fjalë për një raport mbi veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për vitin 2023.

Ju e dini që në zbatim të ligjit ne jemi të detyruar që secili Komision të bëjë raportin e veprimtarisë për vitin pararendës, raport i cili publikohet në faqen zyrtare të KLGJ-së. Kështu që do doja t’i jepja fjalën zonjës Muçi edhe pse s’ka kontribuar në këtë raport (duhet ta pranojmë), por që le ta referojë këtë raport.

*Emona Muçi:* Këtë desha të thosha edhe unë.

Ashtu sikurse edhe ju e thatë, e pranoj që nuk kam qenë pjesë e punës gjatë vitit që kaloi. Po e relatoj këtë raport vjetor të punës.

Sikurse thamë, në bazë të parashikimeve të ligjit 115/2016 parashikohet që brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhje plenare të këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjithë gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (në vijim Komisioni) është një ndër katër komisionet e përhershme. Anëtarë të përhershëm të Komisionit kanë qenë znj.Brikena Ukperaj, znj.Irena Plaku, znj.Yllka Rupa dhe anëtarë zëvendësues znj.Fatmira Luli dhe z.Ridvan Hado. Ky Komisionin ushtron funksionet sipas përcaktimeve ligjore. Me vendimin nr. 742, datë 26.12.2023, për shkak të përfundimit të mandatit të znj.Brikena Ukperaj, është zgjedhur anëtare e Komisionit znj.Emona Muçi. Në datën 28.12.2023 është zhvilluar mbledhja e parë e Komisionit, me përbërje të ndryshuar, në të cilën, me propozim të Kryetares së Këshillit, është zgjedhur kryetare e Komisionit Znj.Emona Muçi.

Ky Komision është asistuar nga tre këshilltaret ligjore znj.Rezarta Taushani, znj. Afërdita Deda dhe znj. Dorina Prifti.

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka organizuar punën me qëllim përmbushjen e funksioneve, duke zhvilluar veprimtarinë e tij në disa drejtime, si më poshtë:

Hartimin, diskutimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore normative që përfshijnë fushën e veprimtarisë së Komisionit, si dhe veprimtari të tjera, në bashkëpunim me Komisionet e tjera të përhershme dhe të përkohshme të Këshillit;

Trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve drejtuar Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së Komisionit dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit për vendimmarrje;

Administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit dhe raportimin vjetor lidhur me këto veprimtari;

Trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit;

Fillimin dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për periudhat e vlerësimit 2013-2016, 2017-2019, 2020-2022 dhe vlerësimin e

përshpejtuar të detyruar, në rastet e konkurrimit të gjyqtarëve për ngritje në detyrë.

Në lidhje me raportimin njëvjeçar- Veprimtaria e komisionit për hartimin e akteve plotësuese të skemës së vlerësimit – rezulton se është miratuar Projekt-akti për miratimin e “Rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i miratuar me vendimin nr. 159, datë 05.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Akti ka si pjesë të tij integrale Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit; “Raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”; “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”; “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”; “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”; “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar”, si dhe Formati standard i tabelës së pikëzimit dhe shkallës së aftësisë së gjyqtarit të komanduar ku pasqyrohen kriteret e vlerësimit, shkalla e aftësisë, pikëzimi dhe niveli i vlerësimit të gjyqtarit të komanduar.

Veprimtaria e komisionit lidhur me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të filluara gjatë vitit 2023.

Gjatë periudhës 1-vjeçare të raportimit lidhur me vlerësimet, Komisioni është angazhuar në:

Kryerjen e gradimeve për periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar;

Kryerjen e vlerësimeve të përshpejtuara të detyruara për vitin e fundit kalendarik për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë;

Kryerjen e vlerësimeve periodike, duke llogaritur fillimin e periudhës së vlerësimit mbi bazën e kohës së punës së kryer nga gjyqtarët në detyrë (periudha vlerësimi 2017-2019, 2020-2022) e ata të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;

Përcaktimi i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele.

Ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi) për 39 (tridhjetë e nëntë) gjyqtarë, si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin duke u cilësuar me vendimet

përkatëse dhe janë listuar gjyqtarët dhe numri i vendimit për të cilin ka fillua procedura e vlerësimit.

Po kështu, gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektvendimet për mosfillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016 për 10 (dhjetë) gjyqtarë, për shkak se procedura e vlerësimit nuk mund të fillonte, në kushtet kur koha e ushtrimit të detyrës ishte më pak se ajo që parashikon ligji dhe për këtë arsye janë miratuar vendimet të listuara në lidhje me mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik - Gjatë vitit 2023, për të gjithë gjyqtarët të cilët kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, apo për gjyqtarët që kanë kandiduar në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, Këshilli ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë. Janë listuar vendimet.

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas Programit të Vlerësimeve të vitit 2023, të miratuar me vendimin nr. 561, datë 29.12.2022, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 me vendimet e listuara gjithashtu në raport.

Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor - Bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve pjesë e të cilit janë edhe rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor të miratuar me vendimin nr.159, datë 05.04.2023, kandidimit në procedurat për ngritje në detyrë, si dhe parashikimeve të nenit 58 të Ligjit për Statusin, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 4 (katër) gjyqtarë, gjatë kohës së komandimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Konkretisht janë cituar vendimet dhe gjyqtarët.

Miratimi i listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele - Bazuar sa më sipër, gjatë vitit 2023, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi verifikoi përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, sipas Skemës së Re të Vlerësimit të Gjyqtarëve, vlerësime të mbaruara, atyre në proces të filluara ose që mund të fillonin sipas programit të vlerësimeve të miratuara nga Këshilli, si dhe bazuar në detyrimin e parashikuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për gjyqtarët që kanë aplikuar për lëvizje paralele, ka paraqitur në Këshill projekt-aktet përkatëse, të cilat miratuar me vendimet më poshtë: Vendimi nr.77, datë 13.02.2023 “Për miratimin e për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023” dhe vendimi nr.346, datë 27.06.2023 “Për miratimin e për miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023”.

Veprimtaria e komisionit lidhur me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të përfunduara gjatë vitit 2023 - Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradim) për periudhën e vlerësimit 2013-2016 – Në vitin 2023, për të gjithë gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional sipas vendimeve të referuara më sipër, si dhe procedurat e filluara në vitin paraardhës, procesi ka vijuar me hapat përkatës, sipas



parashikimeve të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të Skemës së Vlerësimit, duke i dhënë përparësi gradimit, vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarëve që kanë kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatë të Lartë, Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, apo vlerësimeve për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës. Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për 23 (njëzet e tre) gjyqtarë, duke i pasqyruar ato.

Ndërkohë 4 projektraporte vlerësimi etik dhe profesional për periudhën 2013-2016 kanë përfunduar nga ana e relatorëve përkatës dhe i kanë kaluar për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

Gjithashtu, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektvendimet për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016 për 3 (tre) gjyqtarë, për shkak se realizimi i procedurës së vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, ishte objektivisht i pamundur dhe nuk mund të vazhdonte mbi bazën e të cilave janë miratuar vendimet të listuara në këtë raport.

Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik - Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë, të cilat janë miratuar me vendimet që janë pjesë e këtij raporti.

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projekt-aktin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës të vlerësimit të përshpejtuar për 1 (një) gjyqtar, për shkak të rënies së shkakut për të cilin kjo procedurë kishte filluar. Konkretisht është paraqitur në raport vendimi.

Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019 - Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2017-2019 për 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë, të cilat janë miratuar me vendimet që janë bërë pjesë e këtij raporti.

Gjithashtu, Komisioni ka paraqitur në Këshill projekt-aktin për përfundimin pa

vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për 3 (tre) gjyqtarë, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit. Konkretisht vendimet që janë bërë pjesë e këtij raporti.

Ndërsa për 2 (dy) gjyqtarë të tjerë procedurat e filluara janë pezulluar, ndërkohë procedurat e vlerësimit 3-vjeçarë për periudhën 2017-2019 vazhdojnë për 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 - Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për 2 (dy) gjyqtarë, nga të cilat për 1 (një) gjyqtar është miratuar me vendim, ndërsa për gjyqtarin tjetër është në pritje të shqyrtimit nga mbledhja plenare. Konkretisht është bërë pjesë e raportit vendimi.

Ndërkohë procedurat e vlerësimit për periudhën 2020-2022 vazhdojnë për 7 (shtatë) gjyqtarë të tjerë.

Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për ndihmësmagjistrat në Gjykatë të Lartë - Me vendimin nr.7, datë 18.01.2023 Këshilli ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3 vjeçare 2018-2020, për një gjyqtare.

Përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor - Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paraqitur në Këshill projektraportet e vlerësimit etik dhe profesional për 2 (dy) gjyqtarë, të cilat janë miratuar me vendimet përkatëse. Ndërkohë procedurat e vlerësimit për gjyqtarët e komanduar vazhdojnë për 2 (dy) gjyqtarë të tjerë.

Totali i raporteve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli për periudhën 1-vjeçare të raportimit - Në referim të së ma sipër, në total për gjithë periudhën 1-vjeçare të raportimit janë miratuar në Mbledhje Plenare 57 (pesëdhjetë e shtatë) raporte vlerësimi dhe 5 (pesë) projektraporte kanë përfunduar nga ana e relatorëve përkatës dhe i kanë kaluar për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

Pavarësisht kompleksitetit, volumit të punës të procesit të vlerësimit etik dhe profesional dhe një sërë faktorësh që ndikojnë në ecurinë e tij, Komisioni së bashku me Njësinë e Vlerësimit është angazhuar maksimalisht në marrjen e masave për ecurinë dhe përfundimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për të cilët ka

filluar procedura e vlerësimit gjatë vitit 2022 dhe 2023.

Gjithashtu nga ana e Komisionit është bërë edhe trajtimi i kërkesave të gjyqtarëve dhe hartimi i akteve administrative individuale dhe këto akte janë pasqyruar në raport.

Gjithashtu është bërë edhe pasqyrimi i veprimtarive jashtë funksionit - Kërkesat, njoftimet e paraqitura nga gjyqtarët janë konsideruar të aprovuara në heshtje, për shkak të mos shprehjes me vendim brenda afatit 3-javor nga marrja e tyre. Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit të gjyqtarëve, janë evidentuar në regjistrin elektronik të administruar nga Komisioni dhe në përfundim të vitit kalendarik për to është hartuar raporti i arsyetuar.

Gjithashtu në lidhje me bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës, Këshilli bazuar në nenin 33 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Kjo kompetencë e Këshillit është ushtruar nëpërmjet angazhimit të këtij Komisioni, i cili gjatë vitit 2023, ka përgatitur projekt-aktet të cilat janë miratuar me vendimet e listuara në këtë raport.

Në lidhje me çështjet e tjera, komisioni ka trajtuar çdo kërkesë të paraqitur nga gjykatat, gjyqtarët dhe institucione të tjera, që ka të bëjë me fushën e veprimtarisë së tij, si dhe çdo çështje tjetër të adresuar pranë këtij Komisioni për trajtim, duke proceduar sipas rastit me përgatitjen e opinioneve ose kthimin e përgjigjeve përkatëse. Disa nga çështjet e trajtuara janë:

Administrimi i njoftimeve të dërguara nga gjyqtarët, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në seminare, trajnime, konferenca rajonale apo aktivitete të tjera të organizuara nga organizatat të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare, të cilat janë evidentuar në një regjistër elektronik të administruar nga Komisioni;

Trajtim i kërkesave të gjyqtarëve dhe institucioneve lidhur me çështje të cilat përfshihen në veprimtarinë e KVEVP apo kompetenca të tjera të Këshillit, për të cilat është hartuar kthim përgjigje apo adresuar për zgjidhje problematika e bërë prezent;

Në kuadër të trajtimit të çështjeve të etikës, KVEVP gjatë vitit 2023 ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Këshilltarin e Etikës me qëllim hartimin e

Komentarit të Kodit të Etikës, draftimi i të cilit nuk ka përfunduar ende.

Në lidhje me rekomandimet, jemi të vetëdijshëm për sfidat e Këshillit si organ qeverisës në përmbushje të detyrimit për një drejtësi cilësore dhe me efikasitet, që nxit meritokracinë dhe profesionalizimin, Komisioni angazhohet të vazhdojë punën me përgjegjësi dhe përkushtim, me qëllim:

1. Përfundimin e rregullave të detajuara për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit;
2. Vazhdimin e vlerësimit me prioritet të gjyqtarëve që aplikojnë për ngritje në detyrë;
3. Vazhdimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
4. Përfundimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë gjyqtarët e përfshirë në programet periodike të vlerësimit të gjyqtarëve;
5. Vijimin e punës për hartimin e udhëzuesit për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve gjyqësore e monitorimin e shtyrjes së seancave gjyqësore (me asistencë teknike të partnerëve);
6. Vijimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnimin e gjyqtarëve, përditësimin e listës së magjistratëve udhëheqës me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të mentorimit për kandidatët gjyqtarë;
7. Vazhdimin e bashkëpunimit me Komisionet e tjera për plotësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm, si brenda dhe jashtë fushës së veprimtarisë së Komisionit.

Faleminderit për vëmendjen!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Keni ndonjë pyetje?

Nëse jo, atëherë kalojmë në miratimin e projektraportit të veprimtarisë së komisionit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e Raport vjetor të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për vitin 2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raporti vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2023””, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
10. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. Edmond {...}, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raporti vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2023””, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër që edhe kjo ka të bëjë me raportin vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor, për vitin 2023. Fjalën ia jap Kryetarit, z. Ridvan Hado.

*Ridvan Hado:* Raport vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor për vitin 2023.

Komisioni Disiplinor, si një ndër katër Komisionet e Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përgjatë vitit 2023 ka përmbushur, me përgjegjshmërinë më të lartë, të gjitha detyrat e tij, që burojnë nga aktet rregullatore ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 26.12.2023<sup>1</sup>, në zbatim të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i

ndryshuar, vendosi mbi ndryshimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të tij. Aktualisht, në përbërje të Komisionit Disiplinor janë anëtarët e Këshillit:

Z. Ridvan Hado, Kryetar i Komisionit

Znj. Gentiana Muçaj, anëtare

Z. Ilir Rusi, anëtar

Z. Markelian Koça, anëtar zëvendësues

Z. Alban Toro, anëtar zëvendësues.

Komisioni Disiplinor, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në kompetencë të tij, ka kaluar për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor 4 (katër) procedura disiplinore dhe 1 (një) procedurë të mbartur nga viti i mëparshëm. Në vijim të procedurave, nga Këshilli, është proceduar me dhënien e një vendimi jo përfundimtar lidhur me to. Konkretisht:

\* Me vendimin nr. 228, datë 11.05.2023 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratëve B.M dhe R.A, deri në marrjen formë të prerë të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilët është disponuar dhënia e masës disiplinore “Shkarkimin nga detyra”, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

\* Me vendimin nr. 436, datë 19.07.2023 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit S.U, për një periudhë 1 (një) vit, me qëllim përfundimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. S.U., të filluar nga Këshilli në datë 08.05.2023.

\* Me vendimin nr. 437, datë 19.07.2023 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit S.U, për një periudhë 1 (një) vit, me qëllim përfundimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore...

\* Me vendimin nr. 438, datë 19.07.2023... (e njëjta gjë pasi për të njëjtin magjistrat ka pasur tre procedime disiplinore me vendime të veçanta.)

\* Me vendimin nr. 740, datë 26.12.2023 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit K.Dh, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore “Shkarkimin nga detyra”.



Kemi procedurat disiplinore të pezulluara më parë që s'janë të vitit 2023 por që janë gjendje në Komisionin Disiplinor.

\* Me vendimin nr. 463, datë 11.10.2021 është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates E.S, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

\* Me vendimin nr. 559, datë 01.12.2021, për shkak të dhënies së masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj gjyqtarit R.K, deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, i cili me vendimin e tij nr. 14 datë 07.04.2023 ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që e kishte shkarkuar nga detyra magjistratin e sipërcituar. Është vendosur heqja e pezullimit dhe përfundimisht është përfunduar procedimi disiplinor i filluar ndaj këtij magjistrati pa vendim përfundimtar ngaqë kishte humbur statusin e magjistratit.

\* Me vendimet nr. 304, datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit M.K, derisa të përfundonte shqyrtimi i çështjes për të cilin ishte vendosur ky pezullim, nga Gjykata e Lartë, pasi ishte ushtruar e drejta e rekursit. Meqenëse kishte rënë shkak, Komisioni Disiplinor, pasi kishte përfunduar çështja në Gjykatën e Lartë, vendosi të heqë shkakun e pezullimit, t'i kërkojë mbledhjes plenare, pra Komisionit Disiplinor, me vendimin e tij nr. 702 datë 30.11.2023 ka vendosur shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e procedimit disiplinor..., dhe në vijim pastaj, mbasi u shqyrtua u vendos mbyllja e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë - Janë vlerësuar tryezat e përbashkëta të organizuara me institucione të tilla të pavarura si Këshilli i Lartë të Prokurorisë apo Inspektori i Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë patur si qëllim diskutimin e rolit të shërbimeve të inspektimit, si garantues për funksionimin e drejtë dhe të pavarur të sistemit të drejtësisë dhe magjistratëve, sipas standardeve evropiane dhe praktikave më të

mira ndërkombëtare.

Gjithashtu lidhur me rekomandimet e bëra nga Kuvendi i Republikës në rezolutën për vitin 2023, Komisioni Disiplinor, ka kërkuar mbështetje nga Projekti EU4Justice, ku është krijuar Grupi i Punës pranë Këshillit nga Komisioni Disiplinor në bashkëpunim me Komisionin Disiplinor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në lidhje me procedimet disiplinore në referim të paragrafit 2 të nenit 140 të ligjit “Për statusin” në rastin e procedimeve të njëkohshme për të njëjtin fakt të një prokurori dhe një gjyqtari.

Janë bërë disa takime dhe është hartuar një projekt paraprak i cili po diskutohet nga përfaqësuesit e grupit të punës.

Lidhur me rekomandimet e lëna për Këshillin në pikën 11, ku duhet të kontribuojë nëpërmjet kërkesave të motivuara dhe të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, rezulton se nuk ka pasur ndonjë kërkesë specifike nga Këshilli për inspektime tematike.

Komisioni Disiplinor si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kanë treguar përgjegjshmëri dhe kujdes në zbatueshmërinë në praktikë, të gjithë kuadrit normues për procedurat disiplinore, duke përfunduar brenda afateve ligjore dhe të arsyeshme të gjitha procedurat disiplinore të paraqitura për shqyrtim.

Në objektivat e Komisionit Disiplinor, si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2024, mbetet përfundimi i procedimeve disiplinore, të cilat janë të pezulluara.

Në plotësim të rekomandimeve të vendosura në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2023, Komisioni Disiplinor synon të arrijë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Komisionin përkatës, finalizimin në vitin 2024 e një drafti përfundimtar me rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve, për rastet kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore.

Në fokus të Komisionit Disiplinor, ka qenë dhe do të vijojë të jetë, me anë të propozimit të temave trajnuese me objekt çështje të rëndësishme të disiplinës, bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, në drejtim të organizimit të trajnimeve të

përbashkëta.

Ju faleminderit!

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Në fakt unë jua kam çuar edhe me e-mail. Kemi propozimin e rregullores së përbashkët me KLP-në dhe ato kanë propozuar që në shkurt për të caktuar një datë, qoftë për ta miratuar formalisht dhe më pas të kalohet në secilin Këshill. Në qoftë se ju mendoni që ajo është në formën e duhur, mund t'i propozojmë edhe një datë atyre, duke qenë se e kanë sjellë propozimin me shkrim për datën.

Kalojmë në miratimin e projektraportit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord dhe njëkohësisht përfitoj nga rasti të vlerësoj dhe të çmoj kontributin e çmuar që kanë dhënë drejtuesi i mëparshëm i këtij Komisioni por jo vetëm, edhe anëtarët e tjerë të cilëve aktualisht u ka mbaruar mandati. Natyrisht një falënderim edhe vlerësim të veçantë do t'i sugjeroja Këshillit edhe për stafin që ka suportuar të gjithë komisionet në përmbushje të detyrimeve të tyre. Faleminderit!

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord me gjithçka që u tha.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të

Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, relatore znj. Emona Muçi (raporti është përgatitur nga zonja Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)  
10. *Markelian Koça* (anëtar)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Edmond {...}, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektore pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, relatore znj. Emona Muçi (raporti është përgatitur nga zonja Brikena Ukperaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë pa humbur kohë tek çështja e radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën 2013-2016. Gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime por nga ana tjetër ka një e-mail me të cilën ajo dorëhiqet nga prezenca e saj në mbledhje plenare, prandaj dhe magjistratja nuk është këtu prezent sepse ka hequr dorë për të qenë prezent këtu për të diskutuar mbi kundërshtimet.

Zonja Muçi shkurtimisht mbi gjetjet e raportit.

*Emona Muçi:* Procedura në lidhje me vlerësimin e gjyqtares {...}, që ka filluar

me vendimin nr. 239, datë 30.06.2023. Pas dërgimit të dosjes dhe akteve të vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit, me këtë vendim është shortuar, janë përzgjedhur vlerësuesit znj. Brikena Ukperaj, nëpunëse znj. Gilda Hoxha. Është njoftuar nëpërmjet postës për fillimin e procedurës së vlerësimit, për vlerësuesit e përzgjedhur me short, gjithashtu nëpërmjet postës elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe nuk ka kërkuar përjashtimin e vlerësuesve apo të çdo anëtar. Ky projektraport i ishte paraqitur mbledhjes plenare përpara përfundimit të mandatit të znj. {...} e cila është zëvendësuar me znj. Emona Muçi. Është njoftuar në lidhje me këtë ndryshim dhe me këtë procedurë të vendosur nga Këshilli me qëllim paraqitjen e ndonjë pretendimi. Ka rezultuar se ka marrë dijeni, gjithashtu ka marrë dijeni edhe për datën e seancës dhe me një e-mail gjyqtarja ka deklaruar se nuk është më e interesuar. Ka dijeni për datën e mbledhjes por bën me dije se në datën 23.01. ka depozituar në zyrën e protokollit të KLGj-së kërkesën për dorëheqje nga kandidimi për në gjykatën e apelit dhe në këto rrethana nuk është më e interesuar për procedurat e vlerësimit. Në kushtet kur ky vlerësim ka kaluar në mbledhje plenare, shkurtimisht do të relatojë gjetjet e këtij projektraporti duke lexuar vetëm konkluzionet në lidhje me rubrikat konkrete.

“Aftësitë profesionale” - 1.A. Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave – Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit të komanduar për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyrë tërësore burimet me qëllim mbledhjen e informacioneve lidhur me çështjen e trajtuar si dhe në lidhje me përcaktimin e elementeve faktikë të çështjes për trajtim, në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes për trajtim, në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm dhe/ose konfliktit të normave: në konkluzion, Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektores pranë ish-Inspektoratit të KLD-së, ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të ankesës objekt shqyrtimi, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me të dhënat/faktet që rezultojnë nga dokumentacioni dhe informacioni i marrë për efekte të verifikimit të ankesës, duke integruar në përmbajtje të fakteve dhe pjesë të dokumenteve të marra (pjesë nga vendimet gjyqësore të shqyrtuara).

Gjithashtu, rezulton aftësia e gjyqtares së komanduar në pozicionin e inspektores për grumbullimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të nevojshme të marra nga burimet e vlerësimit për qëllime të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, në përputhje me kriteret e caktuara në ligj dhe rregulloren “Mbi sistemin e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve”. Sa i përket identifikimit të normës/normave të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim, në dokumentet burim vlerësimi evidentohen dispozitat ligjore apo aktet nënligjore të KLD-së, në mbështetje të mendimit të inspektorit mbi mënyrën e përfundimit të trajtimit të ankesës. Ndërsa në mbështetje të argumentimit ligjor të inspektores lidhur me gjetjet në raportet konstatues të vlerësimit etik dhe profesional, rezulton se inspektorja identifikon dispozita të ligjit procedural penal ose civil, dispozita të ligjeve organike, etj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin - Në lidhje me aftësinë për të interpretuar ligjin e identifikuar për zgjidhjen e çështjes për trajtim dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi çështjen konkrete; aftësinë për të evidentuar dhe/ose aplikuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale dhe aftësinë për të referuar jurisprudencës relevante: në konkluzion, Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues duke përfshirë edhe vlerësimin periodik të saj për periudhën 2013-2014 për treguesin “Aftësia për të përdorur njohuritë juridike”, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të detyrës në pozicionin e inspektores, ka shfaqur aftësi në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në mbështetje të opinionit të saj në lidhje me trajtimin dhe propozimin për zgjidhjen e çështjeve konkrete apo me analizën e gjetjeve në kuadër të raportit konstatues të vlerësimit etik profesional. Nga ana tjetër nuk evidentohet që ajo t’i ketë kushtuar rëndësinë e duhur, interpretimit të ligjit të zbatueshëm përpara aplikimit të tij mbi faktet e konstatuara, kryesisht në objektet e inspektimit (standardet e arsytimit të vendimi gjyqësor, rivlerësim i masës mjekësore etj.). Po ashtu, nuk rezulton kujdesi i saj për të pasuruar interpretimin e saj mbi ligjin e zbatueshëm dhe mënyrën e aplikimit të tij, me



qëndrime të praktikës gjyqësore të GJK dhe GJL.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin” vlerësohet “Mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor, 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria – në konkluzion, nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore tregon kujdes për pasqyrimin e qartë, konciz dhe të saktë të ankesës apo çështjes objekt verifikimi, të fakteve të çështjes. Në rastin e vlerësimeve, i kushton rëndësi evidentimit të dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, analizës së të dhënave të grumbulluara, arsyetimit ligjor dhe paraqitjes së përfundimeve të nxjerra sipas kritereve matëse të vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë – Në konkluzion, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar sipas llojit dhe natyrës së dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mendimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Po kështu, e njëjta shkallë aftësie rezulton edhe nga raportet konstatues për vlerësimin e gjyqtari apo në dokumentat ligjorë për përfaqësime në procese gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik – në konkluzion, në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, evidentohet se gjyqtarja e komanduar në detyrën e inspektorit ka aftësi për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në ankesë/çështjen e marrë në shqyrtim. Argumentet e dhëna prej saj lidhur me trajtimin e ankesës apo verifikimin e saj janë koncize dhe janë miratuar nga Kryeinspektori. Por dokumentet ligjore dominohen nga përshkrimi i rrethanave objekt inspektimi dhe jo nga analiza ligjore. Argumentimi i gjyqtarës mbi propozimin për ecurinë e trajtimit të ankesës nuk shoqërohet me shkallë shumë të lartë të cilësisë së analizës. Edhe raporti i zgjedhur si dokument ligjor nga ana e gjyqtarës, lidhur me inspektimin tematik në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës përmban vetëm analizë matematikore të të dhëna statistikore lidhur me ngarkesën, kushtet e punës, kohëzgjatjen e gjykimeve...etj, pa u shoqëruar me nxjerrjen e fakteve të nevojshme, të cilat kërkonin një analizë logjike në funksion të qëllimit të inspektimit. Arsyetimi i dokumenteve ligjore në tërësinë e tyre është i qartë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura në ankesë apo në çështjen objekt kundërshtimi, ndërkohë që raportet konstatues të vlerësimit karakterizohen nga shprehje të përgjithësuara e standarde që nuk evidentojnë shkallë të lartë argumentimi në drejtim të aftësive individuale të punës së gjyqtarit. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së gjyqtarës së komanduar, aftësia e saj për këtë tregues vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Në lidhje me “Aftësinë organizative”, 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, 2.A.a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës – duke iu referuar burimeve të vlerësimit, formularit të vetëvlerësimit, në konkluzion, rezulton se nga tërësia, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në detyrën e inspektorit, për dy vitet 2014 dhe 2015 nuk e ka realizuar standardin sasior të volumit të punës për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e saj, ndërsa për vitin 2016 e ka realizuar standardin sasior të volumit të punës në masën 69,4%, duke përfshirë në këtë volum pune jo vetëm trajtimin e ankesave, por edhe angazhimin e saj në procesin e vlerësimeve, përfaqësimet gjyqësore..etj. Për pasojë, në lidhje me treguesin “Aftësia për të realizuar volumin normal të punës” aftësia e gjyqtarës të komanduar në

pozicionin e inspektore vlerësohet në nivelin “Mbi mesataren”, duke pasur në vëmendje këtu edhe vlerësimin periodik të gjyqtares së komanduar për vitet 2013-2014, lidhur me kriterin e aftësive organizative, treguesi “Sasia”. Gjyqtarja e komanduar duhet të vlerësohet me 20 pikë, shkalla e aftësisë “Mbi mesataren”.

2.A.b. Aftësia për të respektuar afatet, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, relacionet e paraqitura nga ana e saj, në konkluzion, referuar i) Sistemit të Vlerësimit të zbatueshëm në rastin konkret; ii) të dhënave burimore në lidhje me kohën e trajtimit të çështjeve, iii) të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit, konkretisht tejkalin e afateve standarde kohore në vitin 2013 me 26,25 % dhe në vitin 2014 me 36,4 %, ; iv) numrit të rasteve të analizuara më lart në të cilat raporti hartohet jashtë afateve, i cili tejkalon 40% të numrit të përgjithshëm të çështjeve të analizuara (tejkalin mbi 70 %), v) faktin që në vlerësimin periodik në periudhën e vlerësimit 2013-2014 për treguesin “shpejtësia” gjyqtarja është vlerësuar “mirë”, aftësia e saj në drejtim të respektimit të afateve vlerësohet në nivelin “Mbi mesatar”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.B. Efektiviteti dhe metodologjia, 2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës – nga burimet e vlerësimit rezulton se në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të punës për trajtimin e rasteve, apo kryerjen e vlerësimeve profesionale rezulton angazhimi i gjyqtares së komanduar për ndjekjen e një metodologjie efektive në drejtim të organizimit të punës. Për pasojë, aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe pikëzohet maksimalisht me 25 pikë.

Në lidhje me 2.C Rregullshmëria dhe saktësia, 2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit - Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes janë të administruara dhe renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin kronologjik të paraqitjes apo hartimit të tyre dhe në tërësi e bëjnë materialin lehtësisht të shfrytëzueshëm nga çdo përdorues. Shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit – Në konkluzion, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjeve (praktikave të verifikimit) janë të plota

dhe të sakta në aspektin formal të tyre, ndërkohë që në një rast rezulton mungesë e dokumenteve (procesverbalit të verifikimit) në praktikën e verifikimit të ankesës. Për këtë arsye duhet të vlerësohet “Mbi mesatare”, duke u pikëzuar me 12 pikë.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, 3.A. Etika në punë, 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion - Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrës dhe jashtë saj, prandaj shkalla e aftësisë në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. Integriteti i gjyqtarit të komanduar, 3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarës, duke u pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit të komanduar, 3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbytjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se znj. {...} ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese. Pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative - Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative” gjyqtarja e komanduar pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Në lidhje me “Aftësinë profesionale dhe angazhimin profesional”, “Aftësia e komunikimit”, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Duhet të vlerësohet shumë e lartë ky komponent duke u pikëzuar me

25 pikë.

4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Duhet të vlerësohet e lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. Aftësia për të bashkëpunuar, 4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale, në konkluzion duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.B.b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit - duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri në dy pikë të tjera, iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarës së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, aftësia e saj në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht, duke u pikëzuar me 5 pikë.

4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë – rezulton që duhet të vlerësohet shumë e lartë duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera – vlerësoj se pjesëmarrja e gjyqtarës së komanduar {...} në aktivitetet trajnuese të Sh.M. dhe trajnime të tjera profesionale pikëzohet me 20 pikë duke u nisur nga pjesëmarrja e saj.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja e komanduar të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese

pranë Shkollës së Magjistraturës apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera. Duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë – nuk rezulton që kjo gjyqtare të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të kësaj natyre dhe duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike – duhet të pikëzohet me 0 pikë për shkak se nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelit të përgjithshëm të vlerësimit:

1. Aftësia profesionale 90 pikë, Shkëlqyeshëm 2. Aftësia organizative 87 pikë, Shumë mirë 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale 100 pikë, Shkëlqyeshëm 4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional 91 pikë, Shkëlqyeshëm. Vlerësimi i përgjithshëm 368 pikë, Shumë mirë.

Në lidhje me këtë projektraport, nga ana e vetë gjyqtares janë paraqitur në datën 11.12.2023 kundërshtime lidhur me projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2013-2016 duke i lidhur kundërshtimet e saj me dy momente. Lidhur me nivelin e vlerësimit në projektraport nuk jam dakord. E kundërshtoj vlerësimin për kriterin e “Aftësisë organizative”, konkretisht në pikën A 2.A.a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës, për të cilin jam kualifikuar në shkallën e aftësisë mbi mesatare me 20 pikë.

Këtë doja të thosha, tani ka hequr dorë. Nga kjo pjesë ka hequr dorë. Për këtë arsye unë vlerësoj, i qëndroj këtij projektraporti.

Më parë ju lexova e-mailin që kishte hequr dorë: “Kam hequr dorë nga të gjitha vlerësimet”, - thotë gjyqtarja. Për këtë arsye mendoj që këto kundërshtime nuk duhet të merren parasysh dhe i qëndroj raportit.

**Naureda Llagami:** Faleminderit zonja Muçi!

Nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga komisioni dhe relatori?

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (Gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”, 368 pikë.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)



*10. Markelian Koça* (anëtar)

*11. Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*

*3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

*5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

*6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

*8. Edmond Hoxhaj, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin e znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Më lejoni ta pasqyroj në mënyrë të sintetizuar këtë relacion për shkak të kohës së mjaftueshme dhe të arsyeshme që keni pasur për njohjen e tij, si dhe të faktit që për shkak të transparencës që e karakterizon këtë Komision, është dhënë një përmbajtje dhe pasqyrim i detajuar i të gjithë veprimit procedural të kryer për pozicionin e hapur me anë

të procedurës së lëvizjes paralele me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023 në lidhje me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Veprimi i fundit procedural në këtë kontekst ka qenë vendimi 589, datë 18.10.2023 ku nga ana e Këshillit është miratuar renditja e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: znj. {...}.

Natyrisht që ky vendim është vënë në dispozicion kandidates së vetme, e cila nuk ka pasur konform pikës 10 të nenit 48 të ligjit “Për statusin” ankim apo pretendime në lidhje me përmbajtjen e saj. Nga ana e relatorit ju propozohet dhe ju sugjerohet të miratoni këtë projektvendim, në dispozitivin e të cilit është përcaktuar si më poshtë:

1. Transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 07.03.2024.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Pas relatimit të bërë nga relatori, nëse nuk kemi diskutime mbi përmbajtjen e projekt-aktit, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit të ardhur.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti mbi transferimin e gjyqtarës znj. {...}, në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 07.03.2024.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Emona Muçi** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Irena Plaku** (anëtare)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Gentiana Muçaj** (anëtare)

*10. Markelian Koça* (anëtar)

*11. Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*

*3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

*5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

*6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

*8. Edmond Hoxhaj, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me përfundimin para kohe të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë. Relator është sërish zoti Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Në rastin konkret më duhet ta pasqyroj në mënyrë të detajuar këtë relacion pasi nga ana e Komisionit është nënvizuar institucioni në nevojë për të cilën do të ishte e vlefshme dhe e rëndësishme që zonja {...} të kontribuonte pranë tij dhe jo atje ku është komanduar. Kështu që në këto kushte më lejoni të pasqyroj shkaqet ligjore dhe arsyetimi përkatës që na ka detyruar të bëjmë këtë propozim.

Më herët me vendimin nr. 4, datë 18.01.2018, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është vendosur:

”1. Të komandojë gjyqtaren {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për të ushtruar detyrën e ndihmësmagjistratit, pranë Gjykatës së Lartë.

2. Afati i kohëzgjatjes së këtij komandimi do të jetë 5-vjeçar”.

Me vendimin nr. 33, datë 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë të gjyqtarës {...}, duke vendosur përsëritjen e mandatit të komandimit me tre vite.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 19.01.2023.

Nga sa më lart, rezulton se afati i komandimit, pas zgjatjes së tij, për gjyqtaren znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë, përfundon më datë 19.01.2026.

Marrë shkas nga thirrja publike e Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarja {...}, më datë 01.02.2023, ka depozituar pranë Këshillit një kërkesë përmes të cilës ka shprehur interesin për t’u transferuar sipas procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, procedura të finalizuara në përputhje me nenin 43 të cilat trajtojnë procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve. Qëllimi i këtij neni është të garantojë zhvillimin e procesit të lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, duke parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë duke garantuar në këtë aspekt qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të të njëjtit nivel. Aktualisht në përfundim të konkurrimit nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele për gjyqtaren {...} finalizohet edhe faza e fundit ajo e transferimit pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ndërkohë me mesazhin elektronik të datës 15.01.2024 gjyqtarja shprehet ndër të tjera se “Unë jam me leje lindje dhe se më datë 7 mars 2024 leja përfundon dhe duhet të kthehem në punë. Përmes këtij emali desha t’ju sjell në vëmendje këtë fakt dhe t’ju shpreh vullnetin apo kërkesën time që procedura e lëvizjes paralele nga Gjykata e Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Korçë në atë Tiranë të përfundojë. Aktualisht, deri në janar të vitit 2026 unë jam e komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë. Duke qenë se e kam marrë këtë zotim ju shpreh

vullnetin se, nëse ju vlerësoni të përshtatshme, ta përfundojë tërësisht afatin e komandimit pranë Gjykatës së Lartë. Nëse ju do ta vlerësoni të nevojshëm që të ndërpritet komandimi dhe të nisë punën në gjykatën ku do të realizohet procedura e përfunduar e lëvizjes paralele, atëherë më datë 7 mars 2024 do të nis punë pranë këtij institucioni..”.

Ndërkohë më parë, siç pasqyrohet nga përmbajtja e vendimit nr. 33, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky i fundit ka proceduar në përsëritjen e mandatit të znj. Ina Hoxha me cilësinë e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. Figura e ndihmësmagjistratit në njësinë e shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë risi e nenit 34 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është krijuar me qëllimin ligjor për të ushtruar veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë: a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim; b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës; c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari. Dallimi kryesor i kategorisë së ndihmësmagjistratëve si magjistratë të komanduar në krahasim me të tjerët qëndron pikërisht tek natyra e shërbimit ligjor që ai ka në përshkrimin ligjor të punës, pasi në dallim nga të tjerët ai është një figurë “quasi” gjyqësore dhe ndihmon gjithashtu edhe në shkëmbimin e përvojave më të mira reciproke në ekspertimin e ligjit. Komandimi i magjistratëve si karakteristikë themelore, pavarësisht nënkategorive të magjistratëve të komanduar apo të llojit të komandimit, ka faktin që lëvizja e autorizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësorë është gjithnjë e përkohshme duke respektuar afatet maksimale të përcaktuar në ligj.

Aktualisht në këtë të fundit ushtrojnë detyrën 19 gjyqtarë, ndërkohë, që Njësia e saj e Shërbimit Ligjor ka në përbërje dhe ushtrojnë detyrën shtatë ndihmësmagjistratë duke përfshirë dhe znj. {...} si dhe njëzet e gjashtë këshilltarë ligjorë. Nga të dhënat e administruara rezulton se në lidhje me ngarkesën e këshilltarëve ligjorë dhe të ndihmësmagjistratëve, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, deri më 31.12.2023 paraqitet si më poshtë vijon:

- Këshilltarët Ligjorë me ngarkesë 6237 çështje.

- Ndhmësmagjistratët me ngarkesë 1281 çështje.

Ndërkohë që për muajin janar, (deri më datë 22.01.2023), ngarkesa në Njësinë e Shërbimit Ligjor është

- Këshilltarët Ligjorë - 229 çështje
- Ndhmësmagjistratët - 87 çështje.

Afërsisht 195 çështje për ndihmësmagjistrat.

Komisioni më tej në kuadër të përgjegjësisë për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor (neni 147 i Kushtetutës) analizoi me kujdes edhe komponentë të statusit të tillë si e drejta për karrierë të gjyqtarës, shprehja e së cilës është edhe interesi i saj për t'u transferuar me anë të lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ngarkesa e kësaj të fundit, ngarkesa dhe rendimenti i njësisë ligjore pranë Gjykatës së Lartë, ku ajo është komanduar, me qëllim identifikimin e institucionit ku dobishmëria e ushtrimit të funksionit të saj do të maksimizohet vlerësuar kjo edhe në aspektin sigurimit, shpërndarjes dhe shfrytëzimin e potencialit njerëzor në funksion të arritjes së qëllimit të sipërcituar.

Parimi i proporcionalitetit rezulton të jetë një instrument i cili ndihmon arritjen e një vendimmarrje të drejtë. Në kushtet kur paraqitet e qartë një ndërthurje interesash publike dhe private të gjyqtarës, të pasqyruar në indikatorët e cituar më lart, kufizimi i tyre do të jetë i pashmangshëm në realizimin e vendimmarrjes. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 17, sanksionohet standardi kushtetues i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, i cili vendos një sërë kriteresh kumulative në formën e garancive kushtetuese për kufizimin e të drejtave themelore.

Duke u nisur nga natyra e së drejtave të cituara është e nevojshme që raporti midis tyre të përcaktohet nga instrumente balancimi të cilat të mundësojnë që ky raport midis të drejtave të realizohet përmes një strukture logjike argumentimi pavarësisht sa të ndryshme janë këto të drejta dhe interesa nga njëri-tjetri. Në funksion të këtij qëllim shërben dhe parimi i proporcionalitetit. Neni 17 i Kushtetutës përcakton detyrimin që kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të jenë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar kufizimin. Pra, raporti përpjesëtimor duhet të dëshmojë se në çmasë kjo përballje midis të drejtave mundëson një balancë të drejtë midis të drejtës së kufizuar (mjete) dhe



mbrojtjes së një interesi publik ose të të drejtës së të tjerëve (qëllimi).

Tradicionalisht ky parim konsiderohet se përbëhet nga 3 elementë. Komisioni duhet të vlerësojë nëse masa e ndërmarrë për të mbrojtur një interes të ligjshëm është:

a) e përshtatshme për arritjen e objektivit të kërkuar, administrimit me efikasitet të burimeve njerëzore, uljes së ngarkesës së çështjeve gjyqësore të gjyqtareve dhe realizmit të një gjykimi të shpejtë.

b) e domosdoshme, në kuptimin që KLGJ nuk kishte asnjë mundësi tjetër në dispozicion që të jetë më pak kufizuese ndaj interesit të cenuar. Kjo do të thotë se masa e ndërmarrë duhet të jetë e nevojshme për të përmbushur një qëllim të caktuar dhe se ky i fundit nuk mund të arrihet me anë të masave të tjera të cilat janë të efektshme dhe njëkohësisht më pak të dëmshme për interesin publik dhe në mënyrë të veçantë të gjyqtarit;

c) proporcionale. Në bazë të këtij elementi të tretë, kontrolli është i orientuar drejt peshimit të interesave të përfshira në konflikt. Pra, përparësitë për të cilat ajo është e preferuar mbi masa të tjera, nuk janë në përpjesëtim me dëmin që ato shkaktojnë.

Në vijim të analizës së sipërcituar vlen të theksohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka kushtuar rëndësi të madhe plotësimit të vakancave të përhershme në të gjithë sistemin gjyqësorë pasi ai ka ndikim të drejtpërdrejtë në realizmin e funksionalitetit të gjykatave dhe në mënyrë të veçantë për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ai bëhet edhe më i ndjeshëm jo vetëm për shkak të burimeve të kufizuara të trupës gjyqësore por edhe kritereve që duhet të gëzojë një gjyqtar që ushtron funksionin pranë kësaj gjykate të kategorisë së parë.

Më konkretisht në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë numri i gjyqtarëve në detyrë ka rënë ndjeshëm si rezultat i zbatimit të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të dorëheqjeve të gjyqtarëve apo dhe komandimit të tyre. Këshilli në shumë vendimmarrje ka konstatuar se ka një përpjesëtim të zhdrejtë të rritjes së numrit të konflikteve gjyqësore dhe pakësim drastik të numrit të trupës gjyqësore, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme dhe të papërbalueshme të ngarkesës së trupës gjyqësore duke u cenuar funksionalitetin në disa komponentë të sistemit gjyqësor por në mënyrë të veçantë dhe shumë serioze në

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionin e Përgjithshëm Tiranë.

Aktualisht, në këto gjykata ushtrojnë detyrën 261 gjyqtarë, pa përfshirë 19 gjyqtarët e emëruar rishtazi që do të caktohen në pozicion, ndërkohë që sipas organikave të këtyre gjykatave ky numër është 368, pra me një diferencë prej 107 gjyqtarësh më pak apo, duke përfshirë edhe gjyqtarët e emëruar rishtazi, 88 gjyqtarë më pak.

Në mënyrë të veçantë panorama për Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga pikëpamja e burimeve njerëzore por edhe ngarkesës së gjyqtarëve ka shkuar drejt përkeqësimit. Struktura organizative e saj është 80 gjyqtarë ku organika në fakt përbehet nga 63 gjyqtarë, ndërkohë që efektivisht në detyrë janë 47 gjyqtarë. Ngarkesa e përgjithshme (të paktën në kohën e hartimit të këtij relacioni) e kësaj gjykate ka qenë në 22000 çështje ku në seksionin civil, seksioni më i ngarkuar, gjyqtarë të caktuar rezultojnë të kenë edhe 2100 çështje. Kjo ngarkesë për disa gjyqtarë ka rënë në 1934 çështje.

Plotësimi i vendeve të përhershme në strukturën e Gjykatës Tirane dhe uljen e ngarkesës së gjyqtarëve vijon të përbëjë prioritet dhe sfidë për KLGJ-në. Duke krahasuar ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë rezultojnë qartë se interesi publik për të patur gjyqtarë që ushtrojnë funksionin në mënyrë të drejtpërdrejtë prevalon jo vetëm për shkak të uljes së ngarkesës së gjyqtarëve, (neni 89 germa b i Ligjit 115/2016) por edhe të përshpejtimit të përfundimit të gjykimeve në një kohë sa më të shpejtë që të jetë e mundur, i cili në rastin konkret për këtë gjykatë rezultojnë të jetë e cenuar.

Interesi publik të drejtimit të funksionalitetit të plotë të gjykatës së sipërcituar vlerësohet si një arsye tejet e justifikuar në kuptim të nenit 57/2 të ligjit 96/2016 “Për statusin” për të vijuar në caktimin përfundimisht të znj. {...} pranë saj si edhe për këtë shkak ndërprejten e komandimit. Në favor të kësaj vendimmarrje rezultojnë të jetë edhe vlerësimi se Znj.Hoxha me konkurrimin nëpërmjet skemës së lëvizjes paralele ka shfaqur vullnetin e saj të plotë dhe të qartë për zhvillimin e karrierës, e drejtë e garantuar nga statusi i gjyqtarit, duke kërkuar të ushtrojë funksionin si gjyqtarë në një gjykatë të kategorisë së parë, kërkesë e cila është në përputhje edhe me nenin 57/2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Marrë shkas, nga konstatimi i faktit se:

i) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konsiderohet – gjykatë në nevojë, dhe ii) znj. Ina Hoxha aktualisht e komanduar si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë, i ka përfunduar procedurat e lëvizjes paralele për t’u transferuar në Gjykatën e Tiranës ku për këtë shkak është e caktuar në mënyrë të përhershme, është e nevojshme vendimmarrja e Këshillit për zgjidhjen e situatës që lidhet me komandimin e kësaj magjistrateje në funksion të përmirësimit të funksionalitetit të Gjykatës së sipërcituar.

Në rastin konkret, kryesisht nga ana e Këshillit konstatohet se për shkak të vlerësimit të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pasi është cenuar një nga kushtet thelbësorë të komandimit sipas nenit 54/4 të ligjit 96/2016 “Për statusin”, kusht i rivlerësuar në raport me rrethanat e reja të krijuara dhe që konkurren me shkaqet ligjore të sipërcituara.

Ndodhur në një situatë të tillë, kur numri i gjyqtarëve në detyrë është ulur ndjeshëm në raport me atë çka, sipas organikave, duhet të jetë, si dhe kur aktualisht Gjykata e Lartë ka një numër të mjaftueshëm ndihmësmagjistratësh dhe këshilltarësh ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar se është në dobi të mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor përfundimi para afatit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë. Për këtë, Komisioni ka propozuar dhe përgatitur projektvendimin ku ju sugjerohet të miratoni:

1. Të deklarojë përfundimin para kohe të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 07.03.2024 (datë të cilën gjyqtarja ka konfirmuar përfundimin e lejes së lindjes dhe gatishmërinë për t’u kthyer në detyrë).
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Të deklarojë përfundimin para kohe të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë me datë 07.03.2024.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Emona Muçi</i></b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>1</sup> Ishte parashikuar si çështje me nr. 9 në rendin e ditës.

- |                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i>  | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>11. Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. Edmond Hoxhaj, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që në fakt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 129, datë 01.04.2021, për kandidaten znj. {...}”. Për më shumë detaje do ta relatojë z. Markelian Koça.

**Markelian Koça:** Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ju paraqesim për shqyrtim projektvendimin e këtij Komisioni në lidhje me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, për kandidaten znj. {...} për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi në këtë pozicion.

Në relacionin bashkëlidhur ju kemi parashtruar faktet se, me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale. Për shkak të bashkimit të gjykatave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në një gjykatë të vetme, ky vend është aktualisht në organikën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ndër të tjera brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër, ka shpallur interes gjyqtarja znj. {...} e cila në momentin e kandidimit dhe aktualisht është e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa caktim të përhershëm në organikën e ndonjë gjykate.

Në vijim ka nisur procedura për verifikimin e kushteve ligjore të kandidimit, me vendimin nr. 180, datë 29.04.2021 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, në përfundim të së cilës është konstatuar ekzistenca e kushteve nga ana e kandidatës në lidhje me kandidimin e saj për këtë vend dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

Me vendim nr. 390, datë 22.09.2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Caktimin e relatorëve. Janë

ndryshuar relatorët për shkak të mbarimit të mandatit pranë KLGJ-së.

Në vijim rezulton që kandidatja znj. {...}, me kërkesën e datës 23.01.2024 protokolluar në Këshill dhe që është vënë në dispozicion së bashku me këtë relacion dhe projektvendimin që paraqesim, deklaroi se heq dorë nga kandidimi, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur në Gjykatën e Apelit Durrës me vendimin nr. 129 datë 01.04.2021.

Në rrethanat si më sipër, referuar parashikimeve ligjore përkatëse që citohen në relacion, duhet të vendoset mbi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për shkak të heqjes dorë dhe vendimi i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik.

Komisioni ka marrë në shqyrtim dorëheqjen dhe ka vendosur ta kalojë në mbledhje plenare duke përpiluar edhe vendimin me këtë strukturë:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.



*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. [...].

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me bashkëpropozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)

<sup>2</sup> Ishte parashikuar si çështje me nr. 10 në rendin e ditës.

- |                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i>  | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>11. Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. Edmond Hoxhaj, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me bashkëpropozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në këshillin e lartë gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit. Për më shumë detaje fjalën e ka z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë, pa humbur kohë po parashtroj relacionin e radhës që ka për

objekt shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit. Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi.

Pa humbur kohë po filloj parashtrimin.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të bërë të mundur realizmin e detyrimeve kushtetuese të parashikuar në nenin 147 të Kushtetutës dhe atyre ligjore që diktojnë ligjet e reformës në drejtësi, si një organ që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, përgjatë veprimtarisë së tij, ka detyrimin të miratojë një numër të madh aktesh administrative të natyrës normative, individuale, rregullore të brendshme e udhëzime jodetyruese.

Për të bërë të mundur këtë duhet:

- i) Një strukturë organizative mirëfunktionale e tij dhe e administratës;
- ii) Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha njësive organizative;
- iii) Rregulla procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të tillë që të bashkëpunojë e bashkërendojë punën, për të siguruar mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Në funksion të sa më sipër, Këshilli ka miratuar me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 strukturën organizative të administratës, i ndryshuar me vendimin nr. 695, datë 21.11.2023, duke parashikuar në këtë strukturë ndër të tjera, Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme si edhe Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqësorëve. Mbështetur në nevojat që kanë Komisionet e Përhershme pranë Këshillit për të pasur kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit Komisioni për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale propozojnë që pranë Këshillit të komandohen gjithsej 5 (pesë) magjistratë profili gjyqtar, 1 (një) në Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme dhe 4 (katër) në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve ka në organikën e saj 7 (shtatë) pozicione nëpunësi përgjegjës për vlerësim, nga të cilët 3 (tre) janë aktualisht të zëna dhe 4 (katër) pozicione janë vakante. Aktualisht të gjithë nëpunësit përgjegjës për vlerësimin kanë statusin e magjistratit. Për shkak të ecurisë së proceseve të vlerësimeve

periodike 3-vjeçare (2017-2019, 2020-2022, 2021-2023), proceseve me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses rivlerësimin kalimtar (Gradimi), vlerësimet e detyruar të përshpejtuara për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele dhe atij ndihmës për organet e rivlerësimit, është urgjente plotësimi tërësisht i kësaj strukture. Prandaj, për të pasur kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit, komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, propozon që pranë kësaj Njësie të komandohen 4 (katër) gjyqtarë të tjerë.

Për sa i përket Njësia Mbështetëse e Komisioneve të Përhershme sipas organikës, ka në përbërje 10 këshilltarë. Nisur nga funksionet kushtetuese dhe përgjegjësitë ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që lidhen me hartimin dhe zbatimin i një game të gjerë aktesh rregullatorë, jo vetëm për Këshillin, por edhe për sistemin gjyqësor, sa i përket rekrutimit të këshilltarëve në këtë Njësi, në kushtet aktuale, Këshilli ka konsideruar që të paktën 3 prej tyre të rekrutohen nga radhët e gjyqtarëve, përmes komandimit.

Aktualisht, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme shërben 1 (një) gjyqtar i komanduar, dhe Komisionet bashkëpropozuese vlerësojnë që pranë kësaj njësie të komandohet 1 (një) gjyqtar tjetër.

Për këtë komisionet iniciues të këtij projektvendimi, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 8, 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, propozojnë hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe 1 (një) pozicion këshilltar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme.

Ky është propozimi. Bashkë me propozimin është edhe projektvendimi përkatës. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Përpara se ta hedhim në votim.

Lidhur me propozimin për datën, mund ta përshejtojmë më shumë apo dyjavëshi është rregull taksativ?

Atëherë, kalojmë në votim, duke lënë afatin e paraqitjes së kërkesës për komandim deri më datë 14.02.2024.

*Illir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Markelian Koça:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Emona Muçi:* Dakord.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurave dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura për 4 (katër) pozicione nëpunës përgjegjës për vlerësimin, si dhe një pozicion këshilltar në njësinë mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme, sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në vendimin e miratuar. Me afatin 14.02.2024.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” / “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 01/2024, të filluar ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Gentiana Muçaj).<sup>3</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)

<sup>3</sup> Ishte parashikuar si çështje me nr. 7 në rendin e ditës.

- |                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>7. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Markelian Koça</b> | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>11. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 8. Edmond Hoxhaj, Birn.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” / “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 01/2024, të filluar ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Gentiana Muçaj).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek çështja tjetër që ka të bëjë me caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e



procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**Gentiana Muçaj:** Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. {...} prot., datë 12.01.2024 ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 16.01.2024, kërkesën me objekt fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistrates znj. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja “dh” dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016.

Gjyqtarja {...} ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Aktualisht është me statusin “E pezulluar”. Me vendimin nr. 437, datë 10.09.2021 të KPK-së është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit znj. {...}. Nga verifikimi i faqes elektronike të Komisionit të Posaçëm të Apelit rezulton se ankimi dhe vendimi i KPK-së janë në proces shqyrtimi deri në vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Kjo magjistrate vazhdon të ruajë statusin e magjistratit për efekt të çdo procedimi disiplinor, në rastet e vërtetimit të një shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të magjistratit të parashikuar në nenet 102-104 të Ligjit nr. 96/2016.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar çështja civile me nr. {...} Akti, datë regjistrimi 21.01.2020, me palë ndërgjyqëse, paditëse: {...} dhe të paditur {...}; me objekt: Detyrimin e palës së paditur që të ndryshojë duke shtuar masën e pensionit ushqimor për fëmijën e mitur {...}. Kjo çështje është gjykuar nga ana e gjyqtares {...}, e cila me vendimin nr. {...}, datë 22.04.2021, ka vendosur: “...Pranimin e kërkesëpadisë [...], etj.

Pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është regjistruar ankesa e shtetasës {...} e cila ankohet në lidhje me zvarritjen e dorëzimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar pas përfundimit të procesit gjyqësor nga gjyqtare {...}. Rezulton që vendimi

është dorëzuar me 5 muaj e pak ditë vonesë nga ana e gjyqtarës dhe konkretisht është dorëzuar në muajin tetor të vitit 2021.

Inspektori i Lartë ka kryer hetim në lidhje me të gjitha dosjet e dorëzuara të zonjës {...} për periudhën 1 janar 2021 deri në momentin që ajo është shkarkuar nga KPK-ja dhe rezulton që ka me vonesë dymujore 3 vendime, me vonesë tremujore 10 vendime, me vonesë nëntëmujore 1 vendim, 11 muaj 1 vendim, 1 vendim 1 vit e dy muaj, dhe në përfundim ILD me vendimin nr. {...} prot., datë 12.01.2024, ka vendosur:

a) Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c) Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Bazuar në nenin 31 të rregullore “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, në cilësinë e relatorit të çështjes u kryen verifikimet mbi ekzistencën e rastit të parashikuar në nenin 139 të Ligjit “Për Statusin” të cilat çojnë Këshillin drejt vendimmarrjes mbi mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore. Këto raste janë parashikuar në mënyrë shteruese në ligj dhe konkretisht: Nëse shkelja disiplinore është parashikuar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të Ligjit “Për Statusin”. Sipas kësaj dispozite përcaktohet se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. Nuk rezulton.

Nga të dhënat referuar vendimeve gjyqësore të dhëna nga magjistratja si dhe referuar datës së vendimit të ILD-së për fillimin e hetimit disiplinor rezulton se hetimi disiplinor është filluar brenda afatit të parashkrimit.

Nëse çështja ka qenë objekt i një procedimi disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezulton se shkeljet e pretenduara, të kenë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, të zgjidhur me vendim të formës së prerë.

Nuk ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja ç dhe d të ligjit “Për statusit”. Sipas këtij neni parashikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të Ligjit “Për Statusin” ose (ii) nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të Ligjit “Për Statusin” ose (iii) magjistrati ka vdekur. Sa referuar, konstatohet se nga verifikimet e kryera dhe nga të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezultoi e provuar ekzistenca e një prej këtyre shkaqeve.

Nëse raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar raporti i hetimit i përgatitur nga Inspektorët përgjegjës, dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e Ligjit për Statusin. Arrihet në përfundimin se raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar dhe plotëson të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë ligjore.

Pra në rastet kur nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e parashikuara në ligj për mbylljen e procedimit disiplinor, në cilësinë e relatorit i propozoj mbledhjes plenare kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore, e cila, si rregull, duhet të zhvillohet brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra nga data 16.01.2024. Në caktimin e datës së seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë afatin 15-ditor të njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin. I bie që data e fundit të jetë data 16 shkurt.

*(Diskutohet data 15 shkurt.)*

**Naureda Llagami:** Atëherë propozimi është për datën 15 shkurt, ora 12:00? Jemi dakord të gjithë?

**Ilir Rusi:** Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

Caktimin e datës 15 shkurt, ora 12:00 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” / “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 02/2024, të filluar ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ilir Rusi).<sup>4</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Emona Muçi** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado** (anëtar)

<sup>4</sup> Ishte parashikuar si çështje me nr. 8 në rendin e ditës.

6. *Irena Plaku* (anëtare)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Zoti Kurushi largohet dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Edmond Hoxhaj, Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” / “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 02/2024, të filluar ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ilir Rusi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e cila ka të bëjë me caktimin e datës

dhe orës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...}.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Në lidhje me këtë procedim disiplinor, bazuar në nenin 72 e vijues të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, jam i detyruar të paraqesë konfliktin tim të interesit. Unë kam marrë pjesë në çështjen penale për të cilën ka iniciuar edhe procedimi disiplinor ndaj kësaj gjyqtareje në gjykatën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kam kryer veprimet si gjyqtar i hetimeve paraprake. Më tej pasi çështja është hedhur në short në seancë paraprake, kjo çështje më është caktuar mua, por në atë kohë kam bërë kërkesën për dorëheqje dhe është miratuar kërkesa për dorëheqje nga kryetari i gjykatës, si gjyqtar i cili ka marrë pjesë në fazën e hetimeve dhe s’mund të merrja pjesë në shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq. Kërkesën për dorëheqje dhe miratimin e dorëheqjes me vendim të kryetarit unë e kam të marrë, më mbrapa siguruar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ndodhur në këto kushte unë deklaroj natyrën e pengesës dhe të konfliktit të interesit që kam në lidhje me këtë çështje, dhe referuar nenit 73 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” deklaroj që kam papajtueshmëri për shkak të pjesëmarrjes në procedimin tim penal. Ndodhur në këto kushte unë deklaroj që nuk do marrë pjesë në diskutimin e të gjithë kësaj çështjeje si dhe nuk do marrë pjesë në votimin e kësaj çështjeje kur të vijë radha për t’u votuar si çështje e radhës në Këshill. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Atëherë zoti Kurushi shkëputet nga mbledhja.

*(Largohet nga salla z. Kurushi.)*

***Naureda Llagami:*** I japim fjalën relatorit shkurtimisht, i cili prezanton faktet.

***Ilir Rusi: Faleminderit!***

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. {...} prot., datë 18.01.2024 ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 19.01.2024, kërkesën me objekt fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistrates znj. {...}, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga nenet 104 pika 3 dhe 111 pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me vendimin nr. 30, datë 24.01.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur të caktojë anëtarin e Komisionit Disiplinor z. Ilir Rusi, në cilësinë e relatorit të çështjes.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në informacionin në mediat audio vizive ka verifikuar dhe administruar të dhëna nga sistemi i menaxhimit të çështjeve dhe konkretisht nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. {...}, datë 12.12.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 15.12.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 315, datë 14.09.2020, ka vendosur: “Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, caktuar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me hetimin disiplinor, në mbështetje të nenit 132 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, në kuadër të hetimit disiplinor, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë administruar në cilësinë e



provës dokumentacioni i paraqitur nga Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe ka referuar shkresat përkatëse.

Nëpërmjet shkresës nr. {...} prot., datë 20.12.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistratja {...} është njoftuar për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë të ILD.

Në vijim të procedurës hetimore, magjistrates {...}, nëpërmjet njoftimit postar datë 23.12.2023, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë datë 26.12.2023, rezulton se i janë dorëzuar dokumentacioni përkatës.

Magjistrate {...} është njoftuar dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet e saj, në lidhje me dorëzimin e parashtresave dhe dokumente mbështetëse brenda tre javëve nga marrja e vendimit të fillimit të hetimit disiplinor.

Gjithashtu magjistratja është njohur me të drejtat e saj, akt të cilin e ka firmosur nëpërmjet njoftimit postar datë 23.12.2023 dhe konfirmimin e këtij akti nuk ia ka përcjellë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga momenti i marrjes në dijeni për fillimin e hetimit disiplinor dhe deri në përpilimin e raportit “Për hetimin disiplinor me iniciativë së magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}” ka rezultuar se magjistratja nuk ka dorëzuar parashtresa apo dokumente mbështetëse, brenda afatit trejavor nga marrja në dorëzim datë 23.12.2023, të vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë së magjistrates znj. {...} me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Duke iu referuar rrethanave dhe fakteve, referuar të dhënave të dosjes hetimore të depozituar në Këshill nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë dhe në analizë të dokumentacionit të administruar, rezulton se: Magjistratja {...} ka ushtruar detyrën gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} deri në datë 05.09.2020, kohë kur është dhënë vendimi nr. {...}, datë 05.09.2020 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar referuar nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç e 25, i Kodit Penal.

Me vendimin nr. {...}, datë 05.09.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, për shtetasen {...} e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”.

Në vijim, Këshilli i Lartë i Gjiqësor me vendimin nr. 315, datë 14.09.2020, ka vendosur: “Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Durrës, caktuar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {...}, datë 15.12.2022, ka vendosur: Deklarimin fajtores të pandehurës {...} për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 319/ç dhe 25 të Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e saj me 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të K. Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pavuajtur të tij, duke e vënë të pandehurën {...} në provë për një periudhë kohe prej 3(tre) vitesh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën e Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin e saj.

Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurën {...} për të ushtruar funksione publike për një afat 5-vjeçar.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {...}, datë 12.12.2023, ka vendosur: “1. Lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë 15.12.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”.

Pranë Këshillit të Lartë Gjiqësor me datë 14.12.2023, me nr. 6407 prot., është protokolluar shkresa nr. {...} prot., datë 13.12.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me lëndë: “Dërgohet urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 69, datë 15.12.2022”.

Me shkresën datë 16.12.2023, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjiqësor me nr. {...} prot., datë 18.12.2023, nga ana e magjistrates {...} është depozituar

“Kërkesë/Relacion lidhur me urdhrin e Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme për ekzekutimin e vendimit nr. {...}, datë 15.12.2022 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Me shkresën datë 22.01.2024, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. {...} prot., datë 24.01.2024, nga ana e magjistrates {...} është depozituar kërkesa drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me objekt: “Pezullimin e procedimit disiplinor të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me kërkesën nr. {...} prot., datë 18.01.2024, për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë”.

Nga ana e ILD-së janë kryer të gjitha procedurat përkatëse dhe ka referuar që ndaj magjistrates të jepet masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Në vijim, nga ana ime si relator, ju njoftoj se së fundi ka ardhur edhe një shkresë në Këshillin e Lartë Gjyqësor nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, protokolluar në datë 30.01.2024 dhe referuar shkresës sonë për informacion nr. {...}, datë 25.01.2024 kemi kërkuar informacionin në lidhje me dhënie informacioni të vendimit të arsyetuar të kësaj gjykate dhe njëkohësisht edhe faktin nëse është bërë rekurs apo jo, dhe sipas shkresës nr. {...} prot., datë 29.01.2024 të kësaj gjykate na është vënë në dispozicion vetëm shkurtimi i vendimit duke na informuar se “... sapo të depozitohet në sekretari vendimi i arsyetuar, do të vihet menjëherë në dispozicion.”.

Gjithashtu kemi edhe shkresën {...} prot., datë 25.01.2024 ku i kemi kërkuar Gjykatës së Lartë të na japi informacion nëse është paraqitur rekurs nga magjistratja {...} dhe njëkohësisht nëse është depozituar apo shqyrtuar ndonjë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit penal, përgjigje e cila deri në këtë moment nuk na ka ardhur.

Bazuar në nenin 31 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor” , në cilësinë e Relatorit të çështjes, u kryen verifikime mbi ekzistencën e rasteve të parashikuara nga neni 139 të Ligjit “Për Statusin”, të cilat çojnë Këshillin drejt vendimmarrjes për mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore. Këto raste janë të parashikuara në mënyrë shteruese në ligj, si vijon:

Nëse shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas

parashikimeve të nenit 117 të Ligjit “Për Statusin”. Sipas kësaj dispozite përcaktohet se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.

Për sa i përket ekzistencës së shkeljes që ka ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor referuar nenit 117, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se gjyqtarja është dënuar me vendim penal nr. {...}, datë 15.12.2022, lënë në fuqi me vendimin penal nr. {...}, datë 12.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit, i cili ka marrë formë të prerë dhe është ekzekutuar me urdhrin datë 13.12.2023 nga S.P.A.K, ndërsa veprimet e konsideruara shkelje sipas fakteve të pranuar nga gjykata i përkasin vitit 2020, brenda afatit 5-vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore dhe si pasojë çështja nuk rezulton të jetë parashkruar. Ndërkohë vlen për t’u theksuar se pavarësisht këtij parashikimi, për shkeljen disiplinore, e cila përbën dhe vepër penale, afatet e parashkrimit përlllogariten sipas dispozitave të Kodit Penal, nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet. Referuar të dhënave në aktet e administruara, rezulton se shkelja disiplinore e pretenduar përbën njëkohësisht dhe vepër penale, sipas nenit 319/ç e 25 të Kodit Penal, nen i cili parashikon dënimin me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Duke pasur në konsideratë datën e fillimit të hetimit disiplinor dhe afatin e parashkrimit për shkeljen disiplinore të pretenduar, i cili është 10 vjet, referuar parashikimeve të nenit 66/1 të Kodit Penal, rezulton se hetimi disiplinor është filluar brenda afatit të parashkrimit.

Nëse çështja ka qenë objekt i një procedimi disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezulton se shkeljet e pretenduara, të kenë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, të zgjidhur me vendim të formës së prerë.

Nëse ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja “ç” dhe “d” të Ligjit “Për Statusin”. Sipas këtij neni parashikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: (i) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të Ligjit “Për Statusin” ose (ii) nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas

parashikimeve të nenit 67 të Ligjit “Për Statusin” ose (iii) magjistrati ka vdekur. Sa referuar, konstatohet se nga verifikimet e kryera dhe nga të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezultoi e provuar ekzistenca e një prej këtyre shkaqeve ligjore.

Nëse raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar raporti i hetimit i përgatitur nga inspektorët përgjegjës, dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e Ligjit për Statusin. Referuar këtij parashikimi ligjor, arrihet në përfundimin se raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar dhe plotëson të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë ligjore.

Në mbledhjen e datës 29.01.2024, Komisioni Disiplinor pasi dëgjoi relatorin e çështjes si dhe u njoh me relacionin e hartuar nga ana e tij, si dhe me aktet e ndodhura në dosjen hetimore vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e datës dhe orës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...}, ose mbyllet e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Sa u parashtrua, në kushtet kur nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e parashikuara në ligj për mbylljen e procedimit disiplinor, në cilësinë e relatorit, i propozoj mbledhjes plenare kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore, e cila, si rregull, duhet të zhvillohet brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra nga data 19.01.2024. Në caktimin e datës së seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë afatin 15-ditor të njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin.

Në këto kushte propozoj si datë për mbajtjen e seancës dëgjimore datën 15 shkurt 2024.

**Naureda Llagami:** Atëherë kemi ndonjë diskutim?

Jemi dakord me propozimin për caktimin më datë 15 shkurt, në vijim të seancës që vendosëm në fillim. Në vijim, 12:30 ose 13:00. Dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë Këshilli caktoi datën 15 shkurt, ora 13:00 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.01.2024)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

11.1 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile;

11.2 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

11.3 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile;

11.4 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

11.5 Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;

11.6 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.

11.7 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. {...}.

11.8 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. {...}.

Shtesë 11.9 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:26 dhe mbaroi në orën 14:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Emona Muçi</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>8. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i>  | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>10. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>11. Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i>         |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
- 2. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sarmela Titka, Përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*



## **8. Edmond Hoxhaj, Birn.**

### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

11.1 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile;

11.2 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

11.3 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile;

11.4 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

11.5 Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;

11.6 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.

11.7 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. {...}.

11.8 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. {...}.

Shtesë 11.9 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}.

*(Rifutet në mbledhjes z. Kurushi.)*

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i fundit për mbledhjen e sotshme, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për transferimin e gjyqtarëve {...}i, {...}, {...}, {...}, {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Për më

shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

**Alban Toro:** Shkurtimisht, sepse kemi të bëjmë me një proces të thjesht administrativ. Të gjithë gjyqtarët të cilët u konsideruan nga ana e Këshillit mbi organikë për shkak të suprimimit të vendeve ku ata ushtronin në mënyrë të përhershme funksionin e tyre, me vendimet e datës 18.01.2024, u kërkua që ana e komisionit t’u drejtoheshin këtyre gjyqtarëve për të bërë një përzgjedhje dhe për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të cilat u ishin propozuar për t’u transferuar në mënyrë të përhershme dhe në këtë kontekst, nga ana e stafit të KLGJ-së është bërë komunikimi me të gjithë gjyqtarët të cilët edhe ju cituat.

Të gjithë gjyqtarët, në përgjithësi, kanë bërë përzgjedhjen e tyre dhe nga ana e Komisionit në përfundim të propozimit të projektit të aktit individual, me anë të së cilës ata do të transferohen në mënyrë të përhershme në gjykatën ku dhe ata kanë bërë përzgjedhjen është proceduar, ndërkohë që me gjyqtaren {...} ka pasur komunikime të disata për shkak të paqartësisë së vullnetit të saj.

Fillimisht në e-mailin e parë të datës 26.01.2024 – nuk po përmbahem në të gjithë përmbajtjen, pasi ajo është një formë plagjiature dhe përmbajtjes së relacionit, por po vij te kërkesa e saj: “Në kushtet kur, nga relacioni i referuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen plenare datë 18.01.2024, përveç tre pozicioneve që më janë ofruar, të listuara në vendimin nr. 2, datë 18.01.2024, ka rezultuar se ka edhe një pozicion tjetër të lirë në mënyrë të përhershme, e konkretisht një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e të drejtës penale (ky pozicion nga ana e Komisionit është propozuar t’i ofrohet gjyqtarit {...}, për të cilin Këshilli vendosi të mos vijojë procedurën e transferimit pa pëlqim, e referuar relacionit të Komisionit është pozicion i lirë i përhershëm, i cili aktualisht nuk i është ofruar asnjë magjistrati tjetër nga ata të cilëve ju suprimohet pozicioni). Duke pasur parasysh këtë fakt, referuar nenit 44 të sipërcituar, kërkoj të më lejoni të ushtroj të drejtën e zgjedhjes duke e përfshirën edhe këtë pozicion në propozimin tuaj.”.

Pra e thënë shkurtimisht ka aplikuar parimin e propozimit nga lart me miratim nga

poshtë, duke kërkuar të ketë në dispozicion katër alternativa. Nuk ka dhënë arsytetime pse ky numër i konsiderueshëm alternativash në raport me gjyqtarët e tjerë, gjithsesi përsëri vetë e ka parë të arsyeshëm t'i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Duke Ju kërkuar ndjesë paraprakisht, Ju sqaroj se, në përgjigje të njoftimit tuaj të datës 23.01.2024, lidhur me ushtrimin e të drejtës së zgjedhjes sipas vendimit nr. 2, dt. 18.01.2024, nga ana ime është ushtruar e drejta e zgjedhjes duke ju drejtuar edhe një kërkesë në datë 26.01.2024. Pasi e kam rilexuar këtë shkresë të dërguar nga ana ime kam konstatuar se vullneti im për të zgjedhur nuk ka dalë i qartë, për këtë shkak Ju sqaroj se lidhur me pozicionet e ofruara nga ana Juaj sipas vendimit nr. 2, unë zgjedh pozicionin që më është ofruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga ana tjetër, duke qenë se përveç këtij pozicioni të lirë që më është ofruar, në të njëjtën gjykatë ka dhe një pozicion të lirë tjetër në fushën e të drejtës penale, do të preferoja këtë pozicion, nëse ai do të më ofrohej nga ana Juaj.”.

Pra duke tentuar të qartësojë, e ka paqartësuar qartësinë edhe në këtë kërkim të këtij e-maili, kështu që u detyruam të kërkonim edhe një qartësim të fundit ku do të kishte vullnetin gjyqtarja për të shkuar/transferuar në mënyrë të përhershme.

Përfundimisht: “Sipas njoftimit tuaj me vendimin nr. 2, 18.01.2024, lidhur me pozicionet e ofruara nga ana juaj unë zgjedh pozicionin që më është ofruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhoma civile.”

Pra përfundimisht shkoi tek propozimi i relatorit.

Për ta përmbyllur, për të gjithë gjyqtarët është përgatitur drafti i aktit individual me anë të së cilës ata transferohen në mënyrë të përhershme pranë gjykatave ku ata kanë bërë përzgjedhjen. Ndërkohë që për gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, për shkak se ata kanë pasur edhe një procedurë transferimi të përkohshme tek gjykatat ku ata tashmë janë transferuar në mënyrë të përhershme, është proceduar edhe me përgatitjen e një drafti individual, me anë të së cilës konstatohet përfundimi para afatit i transferimit të përkohshëm për këta gjyqtarë. Natyrisht që efektet e këtij vendimi fillojnë me datën e sotme, pra me datën 31.01.2024.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë me propozimin e parë që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Miratohet projekt-akti.

**Naureda Llagami:** Kalojmë më pas në transferimin e gjyqtarës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ku është caktuar në mënyrë të përhershme. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord me propozimin.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Miratohet projekt-akti.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek transferimi i gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion në fushën e së drejtës civile. Jemi dakord?

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Dakord.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Markelian Koça:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Emona Muçi:* Dakord.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Miratohet projekt-akti.

*Naureda Llagami:* Transferimi i gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ku është caktuar në mënyrë të përhershme. Jemi dakord?

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Markelian Koça:* Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Miratohet.***

***Naureda Llagami:*** Transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë ku është caktuar në mënyrë të përhershme. Jemi dakord?

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Miratohet projekt-akti.

***Naureda Llagami:*** Transferimi i gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës penale, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ku është caktuar në mënyrë të përhershme. Jemi dakord?

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Në fund kemi dhe projekt-aktet e tjera që kanë të bëjnë me përfundimin përpara afatit të transferimit të përkohshëm.

**Alban Toro:** Përfundimi para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin {...}, {...}. dhe {...}. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.01.2024 (*njësoj efektet për të tre vendimet*). Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve, konform shkronjës “c”, pikës 1, nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*këtu lexohet drafti i vendimit për z. {...}*)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Atëherë, i kalojmë në tërësi të gjithë këto?

Jemi dakord mbi përfundimin para afatit të transferimeve, sikurse relatoi zoti Toro?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohen projekt-aktet sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Me kaq përfundojmë mbledhjen e sotshme, duke u takuar në mbledhjen e ardhshme. Faleminderit!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**